

**KOMUNA E GJILANIT**



**STRATEGJIA**  
**e**  
**ZHVILLIMIT**  
**EKONOMIK LOKAL**  
**2005 - 2007**

**Shkurt 2005**



**PROJEKTI: Zhvillimi i Ndërmarrjeve Lokale nëpërmjet  
Aksionit dhe Aleançës (DELTA II)**

**Projekt për zhvillimin ekonomik, i bashkëfinancuar nga  
Instituti për Shoqëri të Hapur, komunat pjesëmarrëse dhe  
“Friedrich Ebert Stiftung”**



**FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG**



---

### **Vërejtje**

Kjo strategji është hartuar nga Ekipi Komunal, me këshilla dhe udhëzime të Grupit të Bankës Botërore, Institutit për Shoqëri të Hapur dhe “Riinvest”-it. Grupi i Bankës Botërore, Instituti për Shoqëri të Hapur dhe “Riinvest”-i nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e kësaj strategjie, sidoqoftë ato përgëzojnë Ekipin Komunal për cilësinë e punës.

---

<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
	<b>HYRJE .....</b>	<b>1</b>
<b>I.</b>	<b>ORGANIZIMI I PËRPPJEKJEVE .....</b>	<b>3</b>
<b>II.</b>	<b>VLERËSIMI I EKONOMISË LOKALE .....</b>	<b>9</b>
<b>III.</b>	<b>ANALIZA E KONKURRUESE (SWOT) .....</b>	<b>19</b>
<b>IV.</b>	<b>VIZIONI .....</b>	<b>21</b>
<b>V.</b>	<b>SYNIMET DHE OBJEKTIVAT .....</b>	<b>23</b>
<b>VI.</b>	<b>NGA VIZIONI DREJT PROJEKTEVE .....</b>	<b>25</b>
<b>VII.</b>	<b>AMËZA ‘PROJEKTET NË RAPORT ME SYNIMET’ .....</b>	<b>29</b>
<b>VIII.</b>	<b>PLANI IMPLEMENTUES I PROJEKTEVE TË ZHELit.....</b>	<b>33</b>
	<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE .....</b>	<b>37</b>
	<b>ANEKS: PALËT E INTERESUARA .....</b>	<b>73</b>



## HYRJE

---

“Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e Komunës së Gjilanit 2005-2007” ka rezultuar nga Projekti DELTA II. Komuna e Gjilanit është zgjedhur në këtë projekt së bashku me katër komuna të tjera të Kosovës<sup>1</sup>.

DELTA II është bashkëfinancuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI) në Budapest, përderisa vetë komunat pjesëmarrëse në projekt dhe “Friedrich Ebert Stiftung” (FES) kanë kontribuar financiarisht në një masë më të vogël. Banka Botërore nga Uashingtoni mbështeti projektin duke i ofruar asistencë teknike. Projekti është implementuar nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore “Rinvest”, në Prishtinë. Synimi i projektit ishte “aftësimi i komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillim të NVM (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme)”. Përveç synimit, DELTA II ka patur edhe disa objektiva, si forcimi i kapaciteteve të administratës komunale për të hartuar dhe implementuar Strategjitë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (ZHEL), mbështetja e komunave në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e NVM-ve dhe forcimi i partneritetit ndërmjet qeverisë komunale, komunitetit biznesor dhe shoqërisë civile.

Strategjia përmban Vizionin, Synimet, Objektivat, Programet dhe Projektet, të cilat janë të lidhura dhe të harmonizuara me njëra-tjetrën. Strategjia do të konsiderohet si bazë për Qeverinë Komunale të Lipjanit për periudhën e ardhshme trevjeçare 2005-2007.

Si është hartuar Strategjia? Në fillim të procesit për hartimin e strategjisë janë formuar Ekipi Komunal për ZHEL dhe Grupi Punues, si dhe është themeluar

---

<sup>1</sup> Pesë komunat pjesëmarrëse në projektin DELTA II janë: Gjilani, Peja, Ferizaj, Drenasi (ish-Glllogoci) dhe Lipjani.

Forumi i Palëve të Interesuara. Ekipi për ZHEL dhe Grupi Punues kanë marrë mbështetje politike nga udhëheqësit komunalë. Gjatë hartimit të strategjisë janë organizuar katër punëtori (workshops), në të cilat Ekipi për ZHEL i komunës së Gjilanit ka marrë pjesë aktive. Punëtoritë janë ndarë në orë teorike dhe praktike dhe i tërë procesi është ndihmuar nga Ekipi Menaxhues i projektit DELTA II nga “Riinvest”-i, por gjithashtu edhe nga ekspertët vendorë nga “Riinvest”-i dhe konsultantët ndërkombëtarë. Pas çdo punëtorie janë përgatitur planveprimet, të cilat kanë shërbyer si udhërrëfyes për Ekipin Komunal të ZHEL-it, për të zhvilluar aktivitetet hartuese strategjike. Ekipi Komunal, në bashkëpunim me Grupin Punues dhe i mbështetur nga palët e interesuara komunale, ka punuar në grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave dhe definimin e Vizionit, Synimeve, Objektivave, Programeve dhe Projekteve.

Gjithashtu, Ekipi Komunal për ZHEL mori pjesë në vizitën studiuase në Slloveni, nga 26 shtatori deri më 2 tetor 2004, në të cilën u informua lidhur me përvojat sllovene në fushën e ZHEL-it, administratën lokale, hartimin e strategjive zhvillimore, zonat biznesore, inkubatorët biznesorë në Slloveni, etj.

## I. ORGANIZIMI I PËRDPJEKJEVE

---

Në fillim të procesit hartues strategjik, pas marrjes së mbështetjes politike nga kryetari i atëhershëm i Kuvendit Komunal të Gjilanit, Lutfi Haziri, nënkryetari i atëhershëm dhe tani kryetar i Kuvendit Komunal të Gjilanit, Xhemajl Hyseni, si dhe nga kryeshefi ekzekutiv, Enver Muja, u formua grupi i ngushtë - Ekipi Komunal për ZHEL i komunës së Gjilanit. Ekipi përbëhej nga katër anëtarë, të cilët vinin nga Administrata Komunale e Gjilanit, njëri prej të cilëve ka edhe biznesin e vet. Ky ekip përfaqësonte grupin kyç të procesit hartues strategjik. Zyra Komunale e ZHEL-it ishte vendosur në Zyrën për Projekte të Komunës dhe ishte në kontakt të rregullt me kryeshefin dhe e informonte atë rreth procesit. Roli i Ekipi Komunal për ZHEL ishte të koordinojë të gjitha aktivitetet e procesit hartues strategjik.

Anëtarët e Ekipit për ZHEL të komunës së Gjilanit:

1. Fadil Osmani nga Zyra për Projekte e Komunës - udhëheqës i Ekipit
2. Bahrije Mahmuti nga Drejtorati Komunal për Urbanizëm - anëtare
3. Sevdije Maliqi-Hyseni nga Drejtorati Komunal për Urbanizëm - anëtare dhe
4. Hamdi Ismajli – zyrtar komunal dhe përfaqësues i biznesit - anëtar.

Përveç Ekipit të ZHEL-it, gjithashtu u formuan edhe Grupet Punuese Komunale, të cilat përbëheshin nga zyrtarët e drejtorateve të qeverisë Komunale. Këto grupe mbështetën Ekipin e ZHEL-it gjatë tërë procesit të hartimit të strategjisë, me grumbullim të dhënash, këshilla dhe shqyrtim të drafteve të strategjisë.

Grupet Punuese Komunale

- Grupi për ndërmarrje ekonomike dhe bujqësi
- Grupi për planifikim dhe shërbime publike
- Grupi për shoqëri civile dhe komunitete
- Grupi për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar
- Grupi për shëndetsi, arsim, kulturë, rini dhe sport



*Ndërtesa e Kuvendit Komunal të Gjilanit*

Përveç Grupeve Punuese, u formua edhe Forumi i Palëve të Interesuara. Anëtarë të këtij forumi ishin palë të ndryshme komunale si nga administrata, Kuvendi, biznesi, shoqëria civile, etj. Forumi kontribuoi me sugjerime dhe analiza të fazave të ndryshme hartuese strategjike. Forumi i Palëve të Interesuara mbahej në fund të çdo plan-veprimi, kryesisht në zyrat e Qendrës Rajonale Didaktike në Gjilan (shih përbërjen në Aneks 1).

### **Struktura komunale**

Pjesa politike e qeverisë Komunale të Gjilanit (Kuvendi Komunal) ka 41 këshilltarë. Bazuar në rezultatet e zgjedhjeve komunale të datës 26 tetor 2002, struktura politike e Kuvendit është si vijon: Lidhja Demokratike e Kosovës (23 këshilltarë), Partia Demokratike e Kosovës (13 këshilltarë), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (2 këshilltarë) dhe minoriteti serb (3 këshilltarë). Komuna, përveç kryetarit të saj, ka edhe dy nënkryetarë, njëri prej të cilëve është serb. Autoritetet komunale monitorohen nga përfaqësuesi i UNMIKut.

Xhemajl Hyseni – Kryetar  
Lirije Kajtazi – Nënkyetar I  
Bozhidar Periç – Nënkyetar II  
Almaz Zeribun – Përfaqësues i UNMIKut

Dega ekzekutive e qeverisë Komunale (Bordi i Drejtorëve) është e përbërë nga 11 drejtorate:


- Kryeshefi Ekzekutiv - Enver Muja
- Administratë Komunale – Halil Bllaca
- Kulturë, Rini dhe Sport - Bali Sahiti (ushtrues detyre)
- Buxhet, Financa dhe Investime - Fitnete Mjaku
- Arsim - Agim Rexhepi
- Shërbime Publike - Agim Salihu
- Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient - Sevdije Hyseni
- Ekonomi dhe Menaxhment - Nuhi Nuhiu
- Shëndetësi dhe Çështje Sociale - Jashar Ramadani
- Siguri dhe Emergjencë - Hazir Mustafa
- Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi - Murat Hoxha
- Bujqësi dhe Pylltari - Zvonko Petroviq
- Zyra për Komunitete Lokale - Radovan Deniq

Komuna e Gjilanit qeveriset sipas Rregullores së UNMIK 2000/45, e cila qartazi definon përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë. Mirëpo, ekzistojnë disa ligje dhe rregullore të tjera që janë miratuar nga pushtetit qendror e të cilat kanë krijuar konflikt interesash ndërmjet komunës dhe qeverisë qendrore në fushën e shërbimeve të kompanive publike, shërbimit civil të Kosovës, arsimin fillor dhe atij të mesëm, menaxhimit të tokës komunale dhe/ose shoqërore, ku problematika e fundit rrjedh nga fakti se në të kalurën, në shumë raste, dallimi ndërmjet tokës në pronësi komunale dhe shoqërore nuk ka qenë i qartë.

Përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë, sipas Rregullores së UNMIK 2000/45, janë:

- Sigurimi i kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Planifikimi urban dhe rural dhe shfrytëzimi i tokës;
- Licencimi i ndërtimeve dhe zhvillimeve të tjera;
- Mbrojtja lokale e ambientit;
- Implementimi i rregulloreve për ndërtim dhe standardeve për kontroll të ndërtimit;
- Sigurimi i shërbimeve lokale publike dhe të infrastrukturës, duke përfshirë edhe furnizimin me ujë, kanalizimet dhe drenazhet, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave për nxemje lokale;

## Organizimi i Komunës së Gjilanit



- Shërbimet publike, duke përfshirë edhe zjarrfikjen dhe shërbimet emergjente;
- Menaxhimin e pronës komunale;
- Arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm;
- Përkujdesjen primare shëndetësore;
- Shërbimet sociale dhe të banimit;
- Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik;
- Licencimin e shërbimeve, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, transportin lokal publik dhe taksitë, gjuetinë dhe peshkatarinë, si dhe restorantet dhe hotelet;
- Panairët dhe tregjet;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, lagjeve dhe vendeve të tjera publike;
- Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike dhe hapësirave të hapura dhe varrezave;
- Aktivitetet tjera që janë të domosdoshme për administrim adekuat të komunës dhe të cilat nuk janë përcaktuar me ligj.

## Buxheti i Komunës së Gjilanit 2005

Tabela 1. Burimet e planifikuara buxhetore të komunës së Gjilanit për vitin 2005

Organizatat buxhetore	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	Të hyrat vetanake komunale	Total
1. Administrata komunale	1,618,116	2,176,806	2,176,806
2. Arsimi	4,962,240	160,000	5,122,240
3. Shëndetësia primare	938,821	215,730	1,154,551
4. Zjarrfikësit	143,472	-	143,472
5. Zyra e Komuniteteve Lokale	90,368	-	90,368
Total	7,753,017	2,552,536	10,305,553

Burimi: Qeveria Komunale e Gjilanit, 2004

Tabela 2. Pozicionet e shpenzimeve të planifikuara buxhetore të komunës së Gjilanit për 2005

Organizatit buxhetore	Pjesëmarrja absolute në EUR	Pjesëmarrja relative (%) në EUR
1. Administrata Komunale		
Paga	998,350	26.3
Mallra dhe shërbime	1,032,000	27.2
Shpenzimet kapitale	1,764,572	46.5
<b>TOTALI ADMINISTRATA KOMUNALE</b>	<b>3,794,922</b>	<b>100.0</b>
2. Arsim		
Paga	4,379,008	85
Mallra dhe shërbime	743,232	15

TOTALI ARSIMI	5,122,240	100
3. Shëndetësia primare		
Paga	787,449	68
Mallra dhe shërbime	367,102	32
TOTALI SHËNDETËSIA PRIMARE	1,154,551	100
4. Zjarrfikësit		
Paga	89,409	62
Shpenzime kapitale	54,063	38
TOTALI ZJARRFIKËSIT	143,472	100
5. Zyra e Komuniteteve Lokale		
Paga	39,359	44
Mallra dhe shërbime	27,800	31
Shpenzime kapitale	23,209	26
TOTALI ZYRA E KOMUNITETEVE LOKALE	90,368	100
TOTALI SHPENZIMET E PLANIFIKUARA BUXHETORE 2005	10,305,553	

Burimi: Qeveria Komunale e Gjilanit, 2004

Buxheti total i komunës së Gjilanit për vitin fiskal 2005 është planifikuar të jetë 10.305.553 EUR. Ky buxhet përbëhet nga pesë organizata buxhetore:

- 1) Administrata komunale,
- 2) Arsimi,
- 3) Shëndetësia primare,
- 4) Zjarrfikësit dhe
- 5) Zyra e Komuniteteve Lokale.

Burimet financiare të komunës së Gjilanit rrjedhin nga dy drejtime: 1) Granti nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe 2) Të hyrat komunale vetanake. Buxheti total për vitin 2005 është planifikuar të jetë më i vogël se buxheti i vitit 2004 për 12%. Kjo për shkak se të hyrat vetanake komunale janë parashikuar të bien për 34.2% dhe granti nga qeveria qendrore për 1.3%. Mbledhja e të hyrave vetanake komunale për periudhën dhjetëmujore të vitit 2004 ka qenë vetëm 49.3%. Për të njëjtën periudhë, norma arkëtuese e tatimit në pronë ka qenë vetëm 21%.

## II. VLERËSIMI I EKONOMISË LOKALE

---

### **Historia**


Sektorët kryesorë ekonomikë në komunën e Gjilanit deri kah gjysma e shekullit të kaluar kanë qenë bujqësia, e sidomos sektori i blegtorisë. Që nga 1957, filloi ndërtimi i kapaciteteve të fabrikave të tekstilit, duhanit, radiatorëve dhe industrisë së bukës. Industria e Gjilanit ka qenë relativisht stabile deri më 1990, kurse zhvillimin më të hovshëm e ka pasur gjatë periudhës 1957-1986, kur efektet e këtyre ndërmarrjeve janë treguar më së shumti, që rezultoi edhe në rritjen e standardit të jetesës të qytetarëve gjilanas. Gjatë dekadës së kaluarës, për shkak të okupimit, shumë nga kapacitetet industriale janë shkatërruar. Këtyre ditëve, shumica e aktiviteteve ekonomike zhvillohen në tregti.



*Pamje nga Gjilani*

## Pozita gjeografike

Gjilani shtrihet në pjesën lindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës, me një sipërfaqe prej 515 km<sup>2</sup>. Pozita gjeografike i mundëson lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit, duke qenë edhe një qendër e rëndësishme në trekëndshin Gjilan-Preshevë-Kumanovë. Ka klimë të mesme kontinentale, me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë. Në juglindje ka Malet e Karadakut, si dhe një pjesë të Rrafshit të Kosovës. Në veri kufizohet me Prishtinën dhe Artanën (ish-Novobërdën), në veriperëndim me Lypjanin, në perëndim me Ferizajin, në jug me Vitinë, kurse në veri-lindje me Dardanën (ish-Kamenicën). Rrethinën e Gjilanit e përcakton lumi Morava e Binçës, i cili mbledh të gjithë lumenjtë e vegjël, me një prurje mesatare mujore prej 6.7 metra kub/sekond.



*Pozita e Gjilanit në hartën e Kosovës*

## Resurset minerale

Bazuar në hulumtimin e një instituti gjeologjik në vitin 1977, rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe si hekur, leucid, kuarc, dhe krom. Gjithashtu, ekzistojnë resurse minerale në fshatrat Nasalë, Pidiq, Kmetoc dhe Përlepnice. Komuna dallohet nga komunat tjera me një pedologji më homogjene. Në pjesën më të madhe dominojnë tokat ngjyrë kafe në gëlqerore dhe dollomit e më pak toka

fluviale dhe e lagësht. Sidoqoftë, në të kaluarën nuk ka patur ndonjë ekstraktim ekonomik të mineraleve. Në komunë funksionojnë pesë gurthyes: Gllama, Bejta Commerce, Alkos, Dhjetë Vëllezërit dhe Belushi; e gjithashtu edhe dy kompani të ujit mineral, Dea dhe Ola.

## Popullsia

Sipas vlerësimeve<sup>2</sup>, Gjilani me rrethinë në vitin 2002 kishte rreth 131000 banorë, kurse është vlerësuar se numri neto i popullatës (vetëm qyteti) në vitin 2002 ishte rreth 80000 banorë (shih Tabelën 3); 259 banorë në 1 km<sup>2</sup>, 63 vendbanime/fshatra dhe 54 komuna kadastrale. Në hartat seizmike, Gjilani njihet si rajon me shkallë të lartë rrezikshmërie, kjo sidomos pas hulumtimeve që janë bërë me rastin e tërmetit të fuqishëm që goditi komunën më 24 prill 2002.

**Tabela 3. Numri bruto i popullatës në komunën e Gjilanit sipas vlerësimeve**

	1981	1991	2002
Meshkuj	43,294	53,360	67,323
Femra	40,791	50,315	63,501
Gjithsej (Bruto)	84,085	103,675	130,804
Gjithsej (Neto)	35,229	51,912	79,898

*Burimi: Qeveria Komunale e Gjilanit, 2004*

Struktura nacionale e popullsisë së komunës së Gjilanit vlerësohet të jetë kështu: 116.246 shqiptarë (86.9%), 12.500 serbë (9.4%), 133 malazias (0.1%), 936 turq (0.7%), 267 boshnjakë (0.2%), 3.610 romë (2.7%) dhe 32 të tjerë. Vlerësohet se në vitin 2002, numri i banorëve në 1 km<sup>2</sup> ka qenë 254, ose një rritje prej 55.83% në krahasim me vitin 1981, kur numri i banorëve në 1 km<sup>2</sup> ishte 163. Norma vjetore neto e rritjes së popullatës është vlerësuar të jetë rreth 2.3%.

## Papunësia

Me qëllim të zbutjes së papunësisë dhe të avansimit të politikave të punësimit, Qendra Rajonale e Punësimit në Gjilan, e udhëzuar dhe e diktuar nga politikat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, është e angazhuar në këto fusha: participimi më i efektshëm i rajonit të Gjilanit në tregun kosovar të punës, sidomos punësimi i femrës, ndërmjetësimi në punësim, hulumtimi i tregut të punës, punësimi sipas punëkërkuësit dhe sipas grup-moshës dhe nacionaliteteve, aftësimet profesionale etj.

<sup>2</sup> Për shkak të okupimit të Kosovës nga Serbia, regjistrimi i fundit i popullatës në Kosovë është bërë më 1981.

Sipas Qendrës Rajonale për Punësim në komunën e Gjilanit:

- Numri i popullatës aktive është 83,273;
- Numri i të punësuarve në nivel komunal është 20,457;
- Numri i popullatës aktive që kërkojnë punë është 56,783;
- Numri i popullatës aktive që nuk është paraqitur në qendrën për punësim 40,063;
- Përqindja e papunësisë, duke llogaritur popullatën aktive për punë, është 43 %.

Në bazë të shënimeve të Qendrës Rajonale për Punësim, numri më i madh i të papunëve të regjistruar sipas grup-moshave në qershor 2004 ishte mes 25-39 vjeç (rreth 49.6%), prandaj edhe politikat e punësimit duhet të fokusohen më shumë në këtë grup-moshë.

### Ekonomia

Sektori shoqëror po përballet me shumë probleme për shkak të humbjeve të mëdha gjatë periudhës së okupimit (në dekadën e kaluar), por gjithashtu edhe për shkak të transformimit ekonomik pas luftës në Kosovë, pra pas vitit 1999. Pengesat kryesore janë: mungesa e kapitalit qarkullues, sigurimi i lëndës së parë, mungesa e investimeve, humbja e tregjeve, etj. Shpresa e vetme për sektorin shoqëror të ekonomisë mbetet privatizimi i ndërmarrjeve të shëndosha. Ekzistojnë investitorë potencialë lokalë dhe ndërkombëtarë, të interesuar për të investuar në privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, megjithatë, ky proces po ngeç, për shkak të problemeve politike. Tabela 4 tregon ndërmarrjet kyçe në sektorin shoqëror dhe numrin e të punësuarve në to.

**Tabela 4: Ndërmarrjet kyçe shoqërore në Gjilan**

Ndërmarrja	Numri momental i të punësuarve
Fabrika e perdeve dhe tepihëve "Integj"	200
Fabrika e Duhanit	240
Fabrika e Radiatorëve	215
Fabrika e baterive "IBGJ"	200
Shtypshkronja "Grafikos"	60
Kompania hidrondërtimore "Morava e Binçës"	715
Fabrika e bukës "Kualiteti"	129
Fabrika përpunuese metalike për ndërtimtari dhe industri "Çeliku"	187

*Burimi: Ndërmarrjet respektive, 2004*

Sektori privat në Gjilan daton kryesisht nga fundi i viteve të tetëdhjeta (1989), duke u zhvilluar intensivisht gjatë katër viteve të fundit. Sot ekzistojnë 2,737 ndërmarrje që janë të regjistruara dhe funksionojnë në Gjilan, duke punësuar më shumë se 10,000 punëtorë (shih Tabelën 5). Më shumë se 75% e ndërmarrjeve private të regjistruara janë të angazhuara në aktivitete tregtare, duke punësuar më shumë se 63% të numrit total të të punësuarve në sektorin privat. Vetëm 3.5% e ndërmarrjeve janë të angazhuara në krijimin e vlerës së re - në prodhim. Këto ndërmarrje kryesisht importojnë nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, Turqia, Greqia, dhe nga vende të tjera europiane.

**Tabela 5. Përmbledhje e sektorit privat në Gjilan**

Lloji i aktivitetit	Produktet / Shërbimet	Nr. i ndërmarrjeve	Nr. i punëtorëve
Tregtia	Produkte higjienike dhe ushqimore, tekstil dhe lëkurë, pajisje amvisërie, mobilieri dhe mallra të tjera për konsum të përgjithshëm	1,813	6,345
Restaurante, hotele dhe kafeteri	fjetje & mëngjes, ushqim & pije, ahengje familjare, salla për seminare dhe trajnime	244	976
Ndërtimtari dhe byro projektuese	Projektim dhe ndërtim	85	680
Prodhim	Metal & procesim druri, tesktil dhe produkte ushqimore	97	776
Zejtari	Rrobaqepësi, ndreqje flokësh dhe zbukurim, fisnikërim të metalit, përpunim lëkure dhe druri, prodhim betoni dhe argjili	498	1,250
		2,737	10,027

*Burimi: Drejtorati për Ekonomi, Gjilan 2004*

Ekonomia joformale - Një numër personash me zeje të ndryshme si elektrikistë dhe shërbime ndërtimore, floktari, rrobaqepësi, e kështu me radhë, ushtrojnë aktivitetin e tyre pa regjistrim biznesi. Numri real i tyre nuk dihet, por vlerësimet janë se ekzistojnë ndërmjet 150-200 biznese të tilla. Komuna ka bërë përpjekje për t'i bindur të regjistrohen, mirëpo kjo është bërë edhe më e vështirë pas centralizimit të regjistrimit biznesor.

Anketa biznesore - Në një anketë me biznese, të bërë nga Instituti "Riinvest" për nevoja të administratës komunale të Gjilanit, problemet kryesore ekonomike të identifikuar nga bizneset e rajonit të Gjilanit ishin: infrastruktura e pafavorshme, procedurat e gjata të biznesit dhe rregulloret kontradiktore të administratës komunale, që ndërrohen shumë shpesh. Në këtë aspekt, komuna është duke marrë në konsideratë fokusimin e aktiviteteve të saj në të ardhmen e afërt në lehtësimin e aktiviteteve biznesore nëpërmes sigurimit të informatave biznesit, përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës dhe shkurtimit të procedurave biznesore.

Burimet e financimit të biznesit - Burimet kryesore të financimit të firmave janë të ardhurat e tyre vetanake. Edhe pse kapitali bankar është duke e rritur pjesëmarrjen e vet në kapitalin financiar, niveli i tij akoma është i ulët. Ekzistojnë 7 banka private komerciale: Pro-Credit Banka dhe Raiffeissen Banka janë në pronë të aksionarëve internacionalë, kurse Banka e Biznesit Privat, Banka e Re e Kosovës, Banka Kreditore e Prishtinës dhe Banka Ekonomike janë në pronësi të kapitalit vendas, e gjithashtu edhe Kasabank, e cila është në pronësi të kapitalit të përbashkët kosovaro-sloven. Norma mesatare vjetore e kamatës për kredi është e lartë - në mes 10-15%. Asnjë nga bankat komerciale nuk u ofron kredi bizneseve startuese, përveç dy institucioneve mikrofinanciare joprofitabile që operojnë në Gjilan: FINCA dhe Programi i Ndërmarrjeve të Kosovës (KEP), të cilat kreditojnë mikrofirmat vetëm për kapital qarkullues, por kapaciteti financiar i këtyre institucioneve mikrokredituese është shumë i kufizuar, prandaj edhe shuma e kredive është e vogël.

Kapitali askionar akoma është në fazën fillestare të aplikimit, për shkak të mungesës së traditës në këtë rafsh. Megjithatë, ky burim i financimit mund të jetë një burim shumë i rëndësishëm financues në të ardhmën, për shkak të mundësisë së mobilizimit të kapitalit të diasporës, që konsiderohet të jetë bukur i madh në Gjilan dhe rrethinë. Sidoqoftë, deri më tani nuk ka pasur ndërmarrje të studimeve reale për madhësinë e kapitalit të diasporës.

Bujqësia - Klima e mesme kontinentale dhe relievi mjaft heterogjen ofrojnë predispozita të mira për zhvillimin e blegtorisë dhe të lavërtarisë. Gjilani ka rreth 14 200 ha tokë të punueshme, mbi 20 000 ha pyje dhe kulloza, si dhe 13550 ha tokë pasive. Lufta në këto hapësira la gjurmë të rënda dhe me pasoja në infrastrukturën bujqësore, mekanizimin dhe fondin edhe ashtu të varfër blegtoral, dhe kjo ndikoi drejtpërdrejt në dyndjet e popullatës në drejtim të qytetit, pa ndonjë perspektivë për ta dhe për vetë fshatrat e boshatisura dhe sipërfaqet e tokave të lëna djerrina. Sot, niveli i zhvillimit të bujqësisë është mjaft ekstensiv, në pamundësi të mbështetjes institucionale, si dhe pa ndonjë stimulim që fermerët t'i qasen me përkushtim veprimtarisë bujqësore. Veprimtaria ekonomike bujqësore kryesisht është e orientuar në miniferma të pulave vojse me kapacitete të vogla, kultivim të gjedheve me prodhimtari të kombinuar dhe në fushën e lavërtarisë dominojnë kultura e grurit, misrit, thekrës dhe disa bimë foragjere. Një zhvillim ka shënuar edhe lëmia e perimkulturës, si në fushë të hapur, ashtu edhe në hapësira të mbuluara. Gjilani sot disponon me rreth 7,200 krerë gjedhe të racave jo të avansuara, me rreth 4,900 krerë dele, 1,600 krerë dhi dhe afër 1,500 derra, si dhe me rreth 45,000 shpezë të ndryshme, kryesisht pula, në 13 miniferma, me kapacitet prej 600 deri 2,200 pula vojse.

Ekzistojnë disa qumështore si dhe disa ndërmarrje për përpunimin termik të kërpudhave, mishit dhe nënprodukteve të tij. Kombinati bujqësor "Agrokultura",

edhe pse disponon me kapacitete të mëdha, shkallën e shfrytëzimit të tyre e ka në nivel jashtëzakonisht të ulët. Shumë nga objektet e saj u janë dhënë me qira afaristëve të ndryshëm, të cilët kanë ndërruar destinacionin e objekteve të Kombinatit. Kombinati disponon me 466 ha tokë të punueshme, 180 ha të mbuluara me plantacionin e vishnjeve dhe 20 ha me plantacion të kumbullave. Ka fabrikën e prodhimit të ushqimeve të koncentruara, feramat e bibave dhe të dhive, të cilat janë jashtë funksionit. Po ashtu, ky kombinat ka edhe dy njësitë e saj: Frigoriferin dhe Therrtoren. Frigoriferi gjendet në fshatin Shillovë me një kapacitet prej 3,500 t, për llagerim të mallit, dhe 8.5 t të përpunimit të parë termik për një orë. Është i uzurpuar nga minoriteti serb dhe për këtë ka pengesa në privatizimin e tij. Therrtorja, në të cilën është bërë një investim fillestar me mbi 20,000,000 \$, sot shfrytëzohet në një shkallë mjaft të ulët dhe në të kryesisht bëhet përpunimi i produkteve të mishit.

Stacioni për Përparimin e Bujqësisë, edhe pse ka potencial të madh për inkubimin e zogjve dhe trashjen e pulave, ka mbetur jashtë funksionit. Disa nga objektet e saj u janë dhënë disa afaristëve për t'u shfrytëzuar për veprimtari të tjera ekonomike.

Ekzistojnë dy kooperativa bujqësore të cilat, falë donacioneve ndërkombëtare, janë duke funksionuar mirë. Në të parën, KB Malisheva, organizata ndërkombëtare UMKOR ka instaluar një miniqumështore me kapacitet 2,000 l brenda një ndërrimi. Ndërsa, KB Stanishori ka riorientuar veprimtarinë e saj dhe është duke u marrë me përpunimin e ushqimeve të koncentruara.

## **Arsimi**

Sistemi shkollor - Arsimi parafillor zhvillohet në dy çerdhe, kurse arsimi fillor zhvillohet në 29 shkolla fillore, prej të cilave 25 janë të organizuara në gjuhën shqipe, 2 në gjuhën serbe dhe 2 në atë turke. Numri i nxënësve në shkollat fillore është 18,559 me 1,023 mësues; 1,873 nxënës ndjekin mësimin në gjuhët e minoriteteve (në gjuhën serbe dhe turke) me 188 mësues.

Sa i përket arsimit special, Gjilani nuk ka shkollë speciale për nxënësit me nevoja speciale, por shkollat fillore "Rexhep Elmazi", "Abaz Ajeti" dhe "Thimi Mitko" kanë klasë speciale me nxënës të hendikepuar dhe të sëmurë mentalisht.

Ekzistojnë 12 shkolla fillore në Gjilan, prej të cilave 6 janë në gjuhën shqipe me 6,003 nxënës dhe 380 mësues, përderisa 6 të tjera janë në gjuhën serbe me 799 nxënës dhe 107 mësues. Sistemi shkollor i mesëm akoma nuk ofron trajnime praktike të mjaftueshme, por më shumë është i orientuar nga arsimimi i përgjithshëm në fushat e medicinës, makinerisë, bujqësisë, ekonomisë, etj. Sa i përket arsimimit të lartë, në Gjilan funksionon gjithashtu edhe një institucion i arsimit të lartë - Fakulteti i Edukimit, që përgatit mësuesë për sistemin fillor dhe

atë të mesëm arsimor.

Trajnimi profesional - Zyra Rajonale e Punësimit (e udhëhequr dhe e financuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale) ofron trajnime të ndryshme në fushën e makinerisë, informatikës, zdrukthëtarisë, disenjit, etj, me qëllim të lehtësimit të punësimit të njerëzve të rinj. Kjo zyrë gjithashtu është e angazhuar në ndërmjetësim të punësimit. Trajnimet profesionale janë me rëndësi të madhe, duke pasur parasysh se sistemi i mesëm i arsimit në Gjilan nuk është i orientuar në mënyrë adekuate nga trajnimi profesional i nxënësve të shkollave të mesme, me qëllim që ata sa më lehtë të gjejnë punë. Disa organizata të tjera joqeveritare, të cilat ishin të financuara nga organizatat ndërkombëtare, kanë qenë të angazhuara në trajnimin e grave në rrobaqepësi dhe në disa zeje të tjera.

### **Kujdesi shëndetsor dhe social**

Në komunën e Gjilanit kryhen shërbimet primare dhe sekondare mjekësore. Po ashtu, ekzistojnë edhe 2 qendra për trajtime mentale: Qendra për Shërim dhe Qendra për Rehabilitim Mental.

Përkujdesi primar shëndetsor zhvillohet në 31 shtëpi shëndeti dhe ambulanca; tetë prej tyre në lokalitetet serbe. Ekzistojnë po ashtu 51 ordinanca private dhe një numër i madh i barnatoreve private.

Sa i përket **përkujdesit sekondar shëndetsor**, komuna e Gjilanit ka një spital rajonal me 525 të punësuar dhe me 17 reparte: gjinekologjia, interno, dializa, pediatria, kirurgjia, anesteziologjia, ortopedia, urologjia, infektiva, sëmundjet e mushkërive, ndihma e shpejtë, ORL, oftamologjia, laborator, transfuzioni i gjakut dhe materniteti.

Çështjet sociale/humanitare – Në komunën e Gjilanit ndihma marrin 1,775 familje; prej tyre 1,305 familje shqiptare me 15,660 anëtarë, 352 familje serbe me 4,266 anëtarë, 49 familje rome me 590 anëtarë, 43 familje të shpërngulura nga Lugina e Preshevës me 517 anëtarë dhe 26 familje të shpërngulura nga Maqedonia me 308 anëtarë. Qendra për Punë Sociale, e cila funksionon në Gjilan, merret me zgjidhjen e problemeve të adoptimit, shkurorezimi, gjetjes së strehimit për pleq, etj. Nga shtatori 2004 do të fillojë gjithashtu edhe me pagesën e faturave të rrymës për rastet sociale. Posedojnë edhe programe për strehim. Në Gjilan funksionon edhe zyra e Kryqit të Kuq, e cila u ofron ndihma higjienike fëmijëve prej 6 muaj deri në 2 vjeç. Gjithashtu, kjo zyrë ka një program për ndihmë edhe nxënësve filloristë.

### **Infrastruktura**

Infrastruktura fizike për biznese - Një problem shqetësues për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të Gjilanit paraqet mungesa e objekteve dhe tokës për

zhvillimin e bizneseve, gjë që i ka detyruar bizneset të ndërtojnë objekte nga themeli, duke mos pasur parasysh pasojat që ka kjo në planifikimin hapësinor. Ekzistojnë shumë ndërmarrje shoqërore të cilat posedojnë tokë të tepërt dhe të cilën nuk janë duke e shfrytëzuar. Një nga solucionet do të mund të ishte gjetja e një marrëveshjeje, e cila do të mundësonte shfrytëzimin e kësaj toke nga sektori privat.

Rrugët dhe transporti - Gjendja e rrugëve nuk është e kënaqshme. Kjo sidomos vlen për zonat rurale, ku duhet shumë punë dhe angazhim në rregullimin e tyre. Gjatësia e rrugëve në komunë është 154 km. Prej tyre, 52 km janë të asfaltuara, kurse 102 km të paasfaltuara. Duke pasur parasysh që rrugët janë një domosdoshmëri, ato duhet të kenë prioritet në strategji. Në këtë rrafsh, bashkëpunimi i përforcuar ndërkomunal do të çonte kah përmirësimi në infrastrukturën fizike për biznese dhe qytetarë – nëpërmjet bashkëfinancimit të komunave në regjion në fushat e infrastrukturës rrugore, ujësjellësit, kanalizimit, etj.

Sa i përket transportit, gjendja është e mirë. Në komunën e Gjilanit funksionon një ndërmarrje transportuese shoqërore, 21 kompani private transportuese dhe 136 autotaksi; nuk ka hekurudhë, stacioni më i afërt i trenave është në Ferizaj - 33 km larg. Aeroporti më i afërt është në Prishtinë - rreth 60 km larg nga Gjilani.

Ujësjellësi - Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit është mbi 70 km, me dimensione 450-400. Rreth 75-80 % e rrjetit e ka kaluar afatin e eksploatimit. Prej vitit 2000 janë punuar dy rrjete të reja, rrjeti i spitalit 4,000 m gjatësi dhe rrjeti nëpër qytet 5100 m/gjatësi. Vëllimi i pendës së Përlepnicës është 4 000 000 m<sup>3</sup>, ndërsa vëllimi shfrytëzues është 3,200,000 m<sup>3</sup>. Kapaciteti maksimal i prodhimit është 300 l/s, ndërsa kapaciteti i prodhimit momental është 100 l/s. Në këtë ndikon rrjeti i ngushtë 400 i ujësjellësit Përlepnice - Gjilan. "Guri i Hoxhës", varësisht nga stina, jep 60-80 l/s, ndërsa Baja e Qytetit, varësisht nga stina, jep 20-30 l/s. Prodhimi momental është 180-200 l/s. Në fshatra ekzistojnë dy rrjete: Përlepnica 3.3 km - 450 dhe Shillova 3.5 km - 400. Në përfundim e sipër janë edhe tri projekte të ujësjellësit në tri fshatra, me gjatësi të rrjetit 19 km, kapaciteti i prodhimit 25 l/s. Por, të gjitha këto nuk mjaftojnë. Si rrjedhojë e instalimeve të vjetra, shumë ujë humbet gjatë qarkullimit. Gjithashtu, shumë zona nuk janë të lidhura në rrjet. Prandaj, prioritet në këtë fushë duhet të jenë modernizimi i rrjetit në zonat urbane dhe zgjerimi i rrjetit në zonat rurale.

Telekomunikimet - Në Gjilan vepron Njësia e Postës dhe Telekomit të Kosovës, por kapaciteti i telefonisë fikse është i pamjaftueshëm, gjithsej 10,000 numra, ndërsa teknologjia është e vjetëruar dhe daton që nga viti 1980. Prandaj, duhet të mirret parasysh edhe modernizimi i teknologjisë, por edhe rritja e kapacitetit të telefonisë fikse. Numri i parapaguesve në telefoninë mobile Vala 900 është 10,000 por nuk ka mbulim të duhur të rrjetit, gjë që duhet të kihet parasysh nga

organet relevante.

Higjieno-teknika - Ndërmarrja "Higjieno-teknika" punëson 88 punëtorë. Përveç që bën mbledhjen e mbeturinave, kjo ndërmarrje bën edhe pastrimin, larjen dhe fshirjen e pluhurit nga rrugët, bulevardet dhe trotualet, bën mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit, mirëmbajtjen e parqeve, etj. Mbledhja e mbeturinave bëhet po ashtu edhe në fshatrat e komunës. Tani me shërbime të tilla paraqitet nevoja e përfshirjes në zonat më të largëta të komunës. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, ky rrjet nuk posedon sistemin e filtrimit, kurse vetë gjatësia e rrjetit është 60 km në total, duke mos përmbushur nevojat e të gjithë qytetarëve. 80% e rrjetit është më i vjetër se 20 vjet. Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të kanalizimit në fushat rurale duhet të merret gjithashtu parasysh.

Elektroenergji - Në komunën e Gjilanit ekzistojnë 4 TS 35/10 kV: GI-1, GL-2, GL-3 dhe Lladova, 24 km lidhje kablovike dhe 347 km lidhje ajrore me gjithsej 3476 shtylla elektrike dhe 271 trafostacione 10/0.4 kV, me gjithsej 57 MVA fuqi instaluese 35/10(Kv) dhe 51.5 MVA fuqi instaluese Ts 110/35 (KV). Edhe pse shumë pas luftës janë bërë investime në elektroenergji nga donacionet për të forcuar rrjetin energjisjellës, akoma mbetet shumë për të bërë si edhe në aspektet tjera të infrastrukturës fizike. Sikur edhe në pjesët tjera të Kosovës, ekziston mungesë e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë gjatë stinës së dimrit. Kjo është duke ndikuar negativisht në funksionimin e firmave biznesore. Derisa të gjendet një zgjidhje afatgjatë për rrymë jo vetëm për bizneset kosovare por edhe për spektrin e gjerë të konsumatorëve kosovarë, alternativë për t'u marrë parasysh do të ishin kontratat speciale në mes të kompanisë së energjetikës dhe firmave të cilat konsumojnë nivele të larta të rrymës, por edhe për të cilat ndërprerja e rrymës do të kishte pasoja tepër të rënda në biznes.

### **Kultura dhe mediat**

Gjilani është i pasur me objekte të ndryshme kulturore e fetare. Në Gjilan ekziston Teatri Profesional i Qytetit, Biblioteka Rajonale, Kinemaja, 4 shtëpi të kulturës në fshatrat Përlepnicë, Zhegër, Bresalc dhe Llashticë. Po ashtu, Gjilani posedon edhe objekte historike e sidomos vlen të përmenden bustet dhe përmendoret si të patriotëve dhe dëshmorëve të kombit të luftës së fundit në Kosovë, por edhe të rezistencës shumëvjeçare historike. Sa i përket objekteve fetare, në komunën e Gjilanit janë 31 xhami, 9 kisha ortodokse, një kishë katolike si dhe një teqe. Gjilani është i njohur për kulturën dhe tolerancën e vet ndëretnike e ndërjetare.

Në rrafshin e mediave, pos klubit të korrespondentëve që raportojnë nga Gjilani për mediat qendrore të Kosovës, në Gjilan ekzistojnë edhe dy televizione të pavarura si dhe pesë radiostacione: Klubi i Gazetarëve, TV Vali, TV MEN, Radio Gjilani, Radio Victoria, Radio Energji dhe Radio Rinia.

### III. ANALIZA KONKURRUESE (SWOT)

<b>Përparësitë</b>	<b>Dobësitë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Û Popullatë e re dhe e edukuar</li> <li>Û Traditë e fortë ndërmarrëse</li> <li>Û Kushte të favorshme për zhvillim të bujqësisë</li> <li>Û Ujëra minerale</li> <li>Û Komunë ndërkufitare</li> <li>Û Toleranca ndëretnike dhe siguria</li> <li>Û Qendra Rajonale Didaktike</li> <li>Û Qendra Aftësuese / Riaftësuese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Û Financimi i dobët për biznese nga burimet e jashtme</li> <li>Û Bashkëpunimi i dobët ndërmjet komunës dhe bizneseve</li> <li>Û Strukturë e dobët organizuese e komunitetit biznesor</li> <li>Û Mungesa e strategjisë ekonomike</li> <li>Û Mungesa e planit urban</li> <li>Û Të dhëna të vjetra mbitokësore kadastrale</li> <li>Û Mosekzistimi i kadastrit nëntokësor</li> <li>Û Sistemi i vjetëruar i ujësjellësit dhe kanalizimit</li> <li>Û Infrastruktura e pamjaftueshme shkollore</li> <li>Û Mungesa e të dhënave mbi popullsinë dhe ekonomitë familjare</li> </ul>
<b>Mundësitë</b>	<b>Rreziqet</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Û Investimet nga diaspora</li> <li>Û Bashkëpunimi ndërkomunal</li> <li>Û Bashkëpunimi ndërkufitar</li> <li>Û Investimet e huaja</li> <li>Û Fondet trajnuese nga donatorët ndërkombëtarë</li> <li>Û Krijimi i qendrës seizmike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Û Statusi i pazgjidhur politik i Kosovës</li> <li>Û Tërmetet</li> <li>Û Procesi i ngadalshëm i privatizimit</li> <li>Û Mungesa e mbështetjes institucionale të bujqësisë</li> <li>Û Destabilizimi social si rezultat i rritjes së papunësisë</li> <li>Û Migrimi i të rinjve jashtë</li> </ul>



## IV. VIZIONI

---

***Komuna e Gjilanit do të ketë qeverisje efiçente lokale me infrastrukturë të rregulluar urbane dhe rurale; me ambient të pastër dhe të shëndetshëm për jetesë. Tradita e fortë industriale dhe e ndërmarrësisë do të rezultojë në zhvillimin rapid të NVM-ve dhe në rritjen e punësimit. Bashkëpunimi i mirë ndërkufitar do të mundësojë një integrim më të mirë të ekonomive rajonale dhe do të krijojë një ambient të favorshëm për të tërhequr investitorët***



## V. SYNNIMET DHE OBJEKTIVAT

---

S1: Ambient i rregulluar fizik që mundëson zhvillim dhe rritje të biznesit

S1:O1: Nga fundi i vitit 2005 dhe më tej, do ketë thyerje minore të rregulloreve të vëna mbi mbrotjen e ambientit.

S1:O2: Që nga fillimi i 2006, ndërtime ilegale do të reduktohen për 90 % krahasuar me tash.

S2: Infrastrukturë fizike që rrit kualitetin e jetës së qytetarëve dhe përforcon aktivitetet e biznesit në komunë dhe komunitete ndërkufitare.

S2:O1: Që nga viti 2007 e tutje, të sigurohet që sistemi i ujësjellësit dhe i kanalizimit, e gjithashtu edhe rrjeti i rrugëve dhe i telekomunikacionit, të plotësojnë nevojat themelore të 90% të komunitetit.

S2:O2: Deri më 2007, të përmirësohet bashkëpunimi ndërkufitar dhe të mundësohet qasja në Korridorin e Tetë Ndërkombëtar.

S3: Administratë komunale që siguron dhe ofron shërbime për mbështetje të biznesit në mënyrë efektive, të përgjegjshme dhe profesionale.

S3:O1: Deri më 2007, të bëhet avancimi i ambientit punues dhe kapaciteti i administratës komunale

S3:O2: Gjatë vitit 2005, të ndërmerren masa nga administrata komunale për nxitjen e rritjes së investimeve për 30% gjatë periudhës 2005-2007 nga burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe diasporën.

S4: Sistem i ndërtuar trajnues profesional që ndihmon zvogëlimin e papunësisë në komunitet

S4:O1: Deri kah fundi i vitit 2007, 50% e profesionistëve të rinj të trajnuar janë të aftë të gjejnë punë apo të themelojnë kompanitë e tyre.



## VI. NGA VIZIONI DREJT PROJEKTEVE

Vizioni	Synimet	Objektivat	Programet	Projektet	
<p>Komuna e Gjilanit do të ketë qeverisje efiçente lokale me infrastrukturë të rregulluar urbane dhe rurale; me ambient të pastër dhe të shëndetshëm për jetesë. Tradita e fortë industriale dhe e ndërmarrësisë do të rezultojë në zhvillim rapid të NVM-ve dhe rritje të punësimit. Bashkëpunimi i mirë ndërkufitar do të mundësojë një integrim më të mirë të ekonomive rajonale dhe do të krijojë një ambient të favorshëm për të tërhequr investitorët.</p>	<p>S1:  Ambient i rregulluar fizik që mundëson zhvillim dhe rritje të biznesit</p>	<p>S1-O1: Nga fundi i vitit 2005 dhe më tej, do të thyerje minore të rregulloreve të vëna mbi mbrotjen e ambientit</p>	<p>S1-O1-Pg1: Përmirësimi dhe mbrojtja e ambientit</p>	S1-O1-Pg1-Pr1: Promovimi i rregullores komunale për mbrojtje të ambientit	
				S1-O1-Pg1-Pr2: Ripyllëzimi i pyjeve të djegura	
				S1-O1-Pg1-Pr3: Pastrimi i shtretërve të lumenjve	
			<p>S1-O1-Pg2: Menaxhimi efiçient i mbeturinave</p>	S1-O1-Pg2-Pr1: Eliminimi i të gjitha deponive ilegale në qytet	
				S1-O1-Pg2-Pr2: Riciklimi i mbeturinave të grumbulluara	
	<p>S1-O2:  Që nga fillimi i 2006, ndërtimet ilegale do të reduktohen për 90 % krahasuar me tash.</p>			<p>S1-O2-Pg1:  Hartimi i planeve Komunale</p>	S1-O2-Pg1-Pr1: Hartimi i planit zhvillimor
					S1-O2-Pg1-Pr2: Hartimi i planit urbanistik
					S1-O2-Pg1-Pr3: Hartimi i planit rregullativ
				<p>S1-O2-Pg2:  Ndalimi i ndërtimeve ilegale</p>	S1-O2-Pg2-Pr1: Ndërtimi i kapaciteteve të inspektorëve të ndërtimit për të penguar ndërtimet ilegale
<p>S2:  Infrastrukturë fizike që rrit kualitetin e jetës së qytetarëve dhe përforcon aktivitetet e biznesit në komunë dhe komunitete ndërkufitare</p>		<p>S2-O1: Që nga viti 2007 e tutje, të sigurohet që sistemi i ujësjellësit dhe i kanalizimit, e gjithashtu edhe rrjeti i rrugëve dhe i telekomunikacionit, të plotësojnë nevojat themelore të 90% të komunitetit</p>	<p>S2-O1-Pg1: Ndërtimi/Riparimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit</p>	S2-O1-Pg1-Pr1: Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat urbane	
				S2-O1-Pg1-Pr2: Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat rurale	
				S2-O1-Pg1-Pr3: Ndërtimi i sistemit të ujitjes përgjatë lumit Morava	

			S2-O1-Pg2: Ndërtimi/Zgjerimi i rrjetit rrugor dhe të telekomunikacionit	S2-O1-Pg2-Pr1: Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonat urbane.
				S2-O1-Pg2-Pr2: Ndërtimi i rrugëve të reja në rajonet rurale
				S2-O1-Pg2-Pr3: Përmirësimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat urbane
				S2-O1-Pg2-Pr4: Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat rurale.
	S2-O2: Deri më 2007, të përmirësohet bashkëpunimi ndërkufitar dhe të mundësohet qasja në Korridorin e Tetë Ndërkombëtar	S2-O2-Pg1: Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar	S2-O2-Pg1-Pr1: Themelimi i trupës komunale për koordinim ndërkufitar	
			S2-O2-Pg1-Pr2: Organizimi i panairit ndërkufitar	
			S2-O2-Pg1-Pr3: Organizimi i konferencës së donatorëve për financim të projekteve ndërkufitare	
		S2-O2-Pg2: Infrastruktura rrugore për komunikim më të mirë ndërkufitar dhe ndërkomunal	S2-O2-Pg2-Pr1: Kryerja e punimeve në rrugën Gjilan-Stançiq-Kumanovë	
			S2-O2-Pg2-Pr2: Kryerja e projektit për rrugën Gjilan-Zhegoc-Verbicë e Zhegocit-Silovi-Lypjan	
			S2-O2-Pg2-Pr3: Kryerja e projektit për rrugën Zhegër-Goden-Stubëll-Viti	
S3:  Administratë komunale që siguron dhe ofron shërbime për mbështetje të biznesit në mënyrë efektive, të përgjegjshme dhe profesionale	S3-O1: Deri më 2007, të bëhet avancimi i ambientit punues dhe kapaciteti i administratës komunale	S3-O1-Pg1: Zgjerimi i kapaciteteve fizike dhe institucionale të administratës komunale	S3-O1-Pg1-Pr1: Ndërtimi i ndërtesës së re për Kuvendin Komunal	
			S3-O1-Pg1-Pr2: Trajnimi i stafit komunal për teknologji informative	

				S3-O1-Pg1-Pr3: Trajnimi i stafit komunal për hartim dhe menaxhim të projekteve
				S3-O1-Pg1-Pr4: Trajnimi i inspektorëve tatimorë komunalë
		S3-O2: Gjatë vitit 2005, të ndërmerren masa nga administrata komunale për nxitjen e rritjes së investimeve për 30% gjatë periudhës 2005-2007 nga burime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe diasporën	S3-O2-Pg1: Mbështetja tekniko - administrative e bizneseve	S3-O2-Pg1-Pr1: Rregullorja për thjeshtësimin e procedurave administrative biznesore
				S3-O2-Pg1-Pr2: Zyra e Shërbimeve të Shpejta për biznese
				S3-O2-Pg1-Pr3: Publikimi i buletinit për rregullore dhe legjislacion komunal dhe trende ekonomike
				S3-O2-Pg1-Pr4: Themelimi i një trupe komunale për koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe diasporës.
			S3-O2-Pg2: Mbështetja tekniko - financiare e bizneseve	S3-O2-Pg2-Pr1: Ndërtimi i zonës industriale në Shillovë
				S3-O2-Pg2-Pr2: Krijimi i inkubatorit të biznesit
				S3-O2-Pg2-Pr3: Krijimi i fondit për rivitalizim të bujqësisë/bletarisë
				S3-O2-Pg2-Pr4: Formimi i skemës kredituese bujqësore
S4:  Sistem i ndërtuar trajnues profesional që ndihmon zvogëlimin e papunësisë në komunitet	S4-O1:  Deri kah fundi i vitit 2007, 50% e profesionistëve të rinj të trajnuar janë të aftë të gjejnë punë apo të themelojnë kompanitë e tyre		S4-O1-Pg1: Aftësimi praktik i personave të pakualifikuar	S4-O1-Pg1-Pr1: Trajnimi i personave të pakualifikuar në profile të ndryshme.
				S4-O1-Pg1-Pr2: Aftësimi praktik i maturantëve të diplomuar



## VII. AMËZA E PROJEKTEVE NË RAPORT ME SYNIMET

SYNIMET		Ambient i rregulluar fizik, që mundëson zhvillim dhe rritje të biznesit	Infrastrukturë fizike, që rrit kualitetin e jetës së qytetarëve dhe përforcon aktivitetet e biznesit në komunë dhe komunitete ndërkufitare	Administratë komunale, që siguron dhe ofron shërbime për mbështetje të biznesit në mënyrë efektive, të përgjegjshme dhe profesionale	Sistem i ndërtuar trajnues profesional, që ndihmon zvogëlimin e papunësisë në komunitet
		S1	S2	S3	S4
	PROJEKTET				
1	Promovimi i rregullores komunale për mbrojtje të ambientit	X			
2	Ripyllëzimi i pyjeve të djegura	X			
3	Pastrimi i shtretërve të lumenjve	X			
4	Eliminimi i të gjitha deponive ilegale në qytet	X			
5	Riciklimi i mbeturinave të grumbulluara	X			
6	Hartimi i planit zhvillimor	X			
7	Hartimi i planit urbanistik	X			
8	Hartimi i planit rregullativ	X			
9	Ndërtimi i kapaciteteve të inspektorëve të ndërtimit për të penguar ndërtimet ilegale	X			
10	Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat urbane		X		
11	Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat rurale		X		

12	Ndërtimi i sistemit të ujitjes përgjatë lumit Morava		X		
13	Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonat urbane		X		
14	Ndërtimi i rrugëve të reja në rajonet rurale		X		
15	Përmirësimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat urbane		X		
16	Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat rurale		X		
17	Themelimi i trupës komunale për koordinim ndërkuftar		X		
18	Organizimi i panairit ndërkuftar		X		
19	Organizimi i konferencës së donatorëve për financim të projekteve ndërkuftare		X		
20	Kryerja e punimeve në rrugën Gjilan-Stançiq-Kumanovë		X		
21	Kryerja e projektit për rrugën Gjilan-Zhegoc-Vërbicë e Zhegocit-Silovi-Lipjan		X		
22	Kryerja e projektit për rrugën Zhegër-Goden-Stubëll-Viti		X		
23	Ndërtimi i ndërtesës së re për Kuvendin Komunal			X	
24	Trajnimi i stafit komunal për teknologji informative			X	
25	Trajnimi i stafit komunal për hartim dhe menaxhim të projekteve			X	
26	Trajnimi i inkasantëve tatimorë komunalë			X	
27	Rregullorja për thjeshtësimin e procedurave administrative biznesore			X	
28	Zyra e Shërbimeve të Shpejta për biznese			X	
29.	Publikimi i buletinit për rregullore dhe legjislacion komunal dhe trende ekonomike			X	
30.	Themelimi i një trupe komunale për koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe diasporës			X	
31.	Ndërtimi i zonës industriale në Shillovë			X	
32.	Krijimi i inkubatorit të biznesit			X	
33.	Krijimi i fondit për rivitalizimin e bujqësisë/bletarisë			X	
34.	Formimi i skemës kredituese bujqësore			X	
35.	Trajnimi i personave të pakualifikuar në profile të ndryshme				X
36.	Aftësimi praktik i maturantëve të diplomuar				X

Struktura e projekteve është si vijon:

- a) Infrastrukturë institucionale dhe ngritje e kapaciteteve janë 19 projekte
- b) Infrastrukturë fizike janë 17 projekte

Vlera e përgjithshme e investimeve në projektet e identifikuar është 2,729,900.

Burimet e financimit planifikohen nga:

- 1) Burimet komunale, 25.2%
- 2) Qeveria Qëndrore, 36.2%
- 3) Donatorët, 37.1%
- 4) Burimet tjera (komuniteti), 1.6%

*Pasqyra detale e projekteve është si në tabelën VIII.*

## VIII. PLANI IMPLEMENTUES I PROJEKETEVE TË ZHELIT

Nr.	Titulli i projektit	Vlera totale	Burimet e fondeve(%)				Partnerët implementues	Kohëzgjatja	Data e fillimit	Përfituesit
			Komuna	Qeveria Qëndrore	Donatorët	Burimet tjera				
1	Promovimi i Rregullores Komunale për mbrojtje të ambientit	8,000	24%	38%	38%	-	Komuna, MMPH	6 muaj	05/2005	Komuniteti, Shoqata për mbrojtjen e ambientit
2	Ripyllëzimi i pyjeve të djegura	22,000	-	65%	35%	-	Komuna, Shoqata për mbrojtjen e ambientit, MMPH, MBZHR, Ekon. E pyjeve, TMK, KFOR	2 muaj	04/2005	Komuniteti, Qeveria Lokale, Shoqata për mbrojtjen e ambientit, MMPH, MBZHR
3	Pastrimi i shtretërve të lumenjve	26,400	-	50%	50%	-	Komuna (DSHP), Shoqata për mbrojtjen e ambientit dhe donatorët, TMK, MMPH, KFOR	2005/2006	05/2005	Komuniteti, Qev, Lokale, Shoqata për mbrojtjen e ambientit, MMPH,
4	Eliminimi i të gjitha deponive ilegale në qytet	22,100	10%	45%	45%	-	Komuna(DSHP), Shoqata për mbrojtjen e ambientit dhe donatorët, TMK, MMPH, Higjienoteknika	6 muaj	10/2005	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Shoqata për mbrojtjen e ambientit
5	Riciklimi i mbeturinave të grumbulluara	280,000	-	50%	50%	-	Komuna, MMPH, Shoqata për mbrojtjen e ambientit, AER-i dhe donatorë tjerë,	10 muaj	02/2006	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Shoqata për mbrojtjen e ambientit, Biznesi lokal
6	Hartimi i planit zhvillimor	170,000	30%	35%	35%	-	Komuna, MMPH	6 muaj	06/2005	Qeveria lokale, Komuniteti, Shoqata për mbrojtjen e ambientit
7	Hartimi i planit urbanistik	170,000	30%	35%	35%	-	Komuna, MMPH	6 muaj	06/2005	Qeveria lokale, Komuniteti (Biznesi, Qytetarët), Shoqata për mbrojtjen e ambientit
8	Hartimi i planit rregullativ	220,000	46%	27%	27%	-	Komuna (DURA, DKPGJ, EKP),	12 muaj	01/2006	Qeveria lokale, Komuniteti (Biznesi, Qytetarët), Shoqata për mbrojtjen e ambientit
9	Ndërtimi i kapaciteteve të inspektorëve të ndërtimit për të penguar ndërtimet ilegale	15,000	20%	40%	40%	-	Komuna, MMPH, Shoq. e inxh. dhe ark.	3 muaj	09/2005	Qeveria lokale (Inspeksioni, DURA),

10	Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat urbane	2,685,000	40%	30%	30%		Komuna (DSHP, DURA), MSHP, TMK, MMPH, Donatorët, Hidromorava,	2005/2006/2006	02/2005	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Shoqata për mbrojtjen e ambientit, Biznesi lokal
11	Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat rurale	2,560,000	33%	30%	30%	8%	Komuna (DSHP, DURA), MSHP, TMK, MMPH, Donatorët, Hidromorava,	2005/2006/2007	03/2005	Komuniteti (qytetarët), Qeveria Lokale, Shoqata për mbrojtjen e ambientit, Biznesi lokal
12	Ndërtimi i sistemit të ujitjes përgjatë lumit Morava	202,000	10%	40%	40%	10%	Komuna, Shoqatat e bujqve, MBZHR, MPMS, Donatorët	2005/2006/	06/2005	Komuniteti (qytetarët), Qeveria Lokale, Shoqata e bujqve, Biznesi lokal
13	Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonat urbane	2,030,000	40%	30%	30%	-	Komuna (DSHP), (MTT), Donatorët,	2005/2006/2007	03/2005	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Biznesi lokal (prodhues dhe shërbyes)
14	Ndërtimi i rrugëve të reja në rajonet rurale	1,480,000	35%	30%	30%	5%	Komuna (DSHP, DURA), (MTT), Donatorët,	2005/2006/2007	03/2005	Komuniteti (qytetarët), Qeveria Lokale, Biznesi lokal (prodhues dhe shërbyes)
15	Përmirësimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat urbane	610,000	-	70%	30%	-	Komuna, (MTT), PTK, Donatorët,	2005/2006/2007	04/2005	Komuniteti (qytetarët), Qeveria Lokale, Biznesi lokal, PTK
16	Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat rurale	1,220,000	-	40%	20%	40%	Komuna, (MTT), PTK, Donatorët,	2005/2006/2007	04/2005	Komuniteti (qytetarët), Qeveria Lokale, Biznesi lokal, PTK
17	Themelimi i trupës komunale për koordinim ndërkufitar	21,000	10%	40%	50%	-	Komuna, Ministria, OJQ-të ndërk.(EWI, CRS, etj)	3 muaj	01/2006	Qeveria lokale dhe qytetarët, Shoqatat lokale të mikroregionit
18	Organizimi i panairit ndërkufitar	25,500	20%	30%	35%	15%	Komuna, Shoqatat lokale, Qeveria Qendrore, Ojq-të ndërkombëtare (EWI, CRS)	1 javë	05/2006	Qeveria lokale dhe qytetarët, Biznesi lokal, Oda ekonomike, Shoqatat e biznesit
19	Organizimi i konferencës së donatorëve për financim të projekteve ndërkufitare	6,400	40%	40%	20%	-	Komuna, Qeveria Qendrore, Ojq-të ndërkombëtare (EWI, CRS)	3 ditë	10/2005	Qeveria lokale dhe qytetarët, Biznesi lokal, Oda ekonomike, Shoqatat e biznesit
20	Kryerja e punimeve në rrugën Gjilan-Stançiq-Kumanovë	2,080,000	10%	45%	45%	-	Komuna, (MTT), Donatorët (Org. ndërk),	2005/2006/2008	04/2005	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Biznesi lokal dhe ndërkufitarë, Qarkullimi ndërk.
21	Kryerja e projektit për rrugën Gjilan-Zhegoc-Vërbicë e Zhegocit-Sillovi-Lipjan	1,650,000	15%	50%	35%	-	Komuna (Gjilan, Viti), (MTT), Donatorët,	2006/2007	02/2006	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Biznesi lokal dhe ndërkomunal, Qarkullimi ndërkomunal

22	Kryerja e projektit për rrugën Zhegër-Goden-Stubëll-Viti	675,000	5%	50%	45%	-	Komuna (Gjilan, Lypjan), (MTT), Donatorët,	2006/2007	02/2006	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Biznesi lokal dhe ndërkomunal, Qarkullimi ndërkomunal
23	Ndërtimi i ndërtesës së re për Kuvendin Komunal	1,564,452	10%	60%	30%	-	Komuna, MSHP, MEF, Donatorët,	2006/2007	03/2006	Komuniteti (qytetarët), Qev. Lokale, Biznesi lokal, OJQ-të lokale
24	Trajnimi i stafit komunal për teknologji informative	15,100	10%	50%	40%	-	Komuna, OJQ-të lokale, MSHP	2 muaj	04/2005	Shërbimi civil komunal
25	Trajnimi i stafit komunal për hartim dhe menaxhim të projekteve	18,100	25%	40%	35%	-	Komuna, Qeveria Qendrore, OJQ-të ndërkombëtare, OJQ-të lokale	2 muaj	09/2005	Qeveria lokale dhe qytetarët, Donatorët, Ministrinë (Grantet e tyre)
26	Trajnimi i inspektorëve tatimorë komunalë	10,500	10%	45%	45%	-	Komuna, MEF, Donatorët	1 muaj	06/2005	Qeveria lokale (shërbimi i inkasimit, Drejtoria për buxhet dhe financa), Qytetarët, MEF
27	Rregullorja për thjeshtësimin e procedurave administrative biznesore	7,900	20%	40%	40%	-	Komuna, MEF, MTI, MPL, Organizatat Ndërkombëtare, Shoqatat afariste	3 muaj	09/2005	Qeveria lokale, Shoqatat afariste, Biznesi, MEF, MTI,
28	Zyra e Shërbimeve të Shpejta për biznese	31,900	10%	45%	45%	-	Komuna, Organizatat ndërkombëtare, Shoqatat afariste dhe të ekonomistëve	2 muaj	06/2005	Qeveria lokale, Biznesi (ekzistues dhe potencial), MTI
29	Publikimi i buletinit për rregullore dhe legjislacion komunal dhe trende ekonomike	10,800	30%	35%	35%	-	Komuna, Qeveria Qendrore (MSHP, MEF, MEF, MTI), Donatorët	2005/2006/2007	05/2005	Kuvendi komunal, Qytetarët, Shoqatat dhe OJQ-të Lokale, Qeveria e Kosovës,
30	Themelimi i një trupe komunale për koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe diasporës	6,300	25%	35%	40%	-	Komuna, Shoqatat lokale, Ministrinë përkatëse	2 muaj	10/2005	Diaspora, Qeveria lokale, Ministrinë përkatëse
31	Ndërtimi i zonës industriale në Shillovë	1,155,000	15%	40%	40%	5%	Komuna, MEF, Komuniteti i biznesit, Diaspora, Investitorët potencialë	2006/2007	02/2006	Komuniteti (qytetarët), Qeveria Lokale, Biznesi lokal, Investitorët e jashtëm, Diaspora
32	Krijimi i inkubatorit të biznesit	860,000	15%	40%	40%	5%	Komuna, MEF, Komuniteti i biznesit, Diaspora, Donatorët	6 muaj	06/2005	Komuniteti (qytetarët e papunë), Qeveria Lokale, Biznesi i sapofilluar, Diaspora
33	Krijimi i fondit për rivitalizimin e bujqësisë/bletarisë	165,600	20%	35%	40%	5%	Komuna, Shoqatat lokale, Ministria e bujqësisë, Organizatat ndërkombëtare	3 muaj	04/2005	Ndërmarrësit bujqësor, Qeveria Lokale, Ministria e bujqësisë

34	Formimi i skemës kredituese bujqësore	165,600	20%	35%	40%	5%	Komuna, Shoqatat lokale të bujqve, MEF, MBZHR, Organizatat ndërkombëtare, Bankat	12 muaj	01/2006	Ndërmarrësit bujqësor, Qeveria Lokale, Ministria e bujqësisë
35	Trajnimi i personave të pakualifikuar në profile të ndryshme	25,800	20%	40%	40%	-	Qendra Regjionale e Punës, Qeveria lokale/DEM, Qeveria Qëndrore (MTI, MPMS, MPL), Shoqatat afariste dhe të zanatlinjëve, Organizatat Ndërkombëtare	12 muaj	08/2005	Shoqata afariste dhe të zanatlinjëve, Të papunët, qendra regjionale e punësimit
36	Aftësimi praktik i maturantëve të diplomuar	5,800	20%	40%	40%	-	Qendra e Punës (MPMS), Qeveria lokale, Shoqata e afaristve dhe të zanatlinjëve, Organizatat Ndërkombëtare	3 vite	09/2005	Maturantët e sapodiplomuar, Qeveria Lokale, Shoqata Afariste dhe të tjera, ndërmarrjet e biznesit

### Shkurtesat dhe akronimet

- MMPH** – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsiror  
**MBZhR** – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
**MShP** – Ministria e Shërbimeve Publike  
**MPMS** – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
**MFE** – Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
**MTT** – Ministria e Transportit dhe Telekomunikimeve  
**MTI** – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
**MPL** – Ministria e Pushtetit Lokal  
**KEK** – Korporata Energjetike e Kosovës  
**AER** – Agjensia Europiane për Rindërtim  
**DKPGj** – Departamenti për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi  
**EKP** – Ekipi Komunal për Planifikim  
**DPSH** – Departamenti i Shërbimeve Publike  
**DURA** – Departamenti për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient  
**DEM** – Departamenti për Ekonomi dhe Menaxhment  
**TMK** – Trupat Mrojtëse të Kosovës  
**EWI** – East-West Institute (Instituti Lindje-Perëndim)  
**CRS** – Catholic Relief Services (Shërbimet Katolike Lehtësuese)  
**QRP** – Qendra Regjionale për Punësim



## PËRSHKRIMI I PROJEKTEVE

<b>Projekti 1</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b>Promovimi i rregullores komunale për ruajtjen e mjedisit</b>		<b>Përmirësimi dhe mbrojtja e ambientit</b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Qëllimi i projektit ka të bëjë me promovimin e rregullores për ruajtjen e mjedisit. Duhet theksuar se gjendja e mjedisit para luftës ka qenë shqetësuese, sepse mjedisit i është kushtuar shumë pak kujdes. Kur e themi këtë, kemi parasysh se Gjilani ka pasur një industri të zhvilluar dhe nuk ka pasur trajtim të ujërave të zeza dhe industriale, ka pasur monitorim jo të duhur të kualitetit të ajrit, menaxhim të dobët të mbeturinave, deponi josanitare, shfrytëzim joracional të resurseve natyrore etj.</p> <p>Në bazë të kësaj rregulloreje, zhvillimi i komunës duhet mbështetur në baza të shëndosha – të qëndrueshme, në mënyrë që të krijohen kushte për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet e dëmshme për popullatën. Detyra primare do të jenë: ruajtja e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit, menaxhimi i suksesshëm i hedhurinave dhe ruajtja e biodiversitetit.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njoftimi i qytetarëve me rreguloren në fuqi</li> <li>- Vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Mundësia e hartimit të strategjisë afatgjate për mbrojtjen e ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale dhe mediat lokale</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i rregullores së aprovuar</li> <li>- Ekzistimi i shumë OJQ-ve lokale të ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i OJQ-ve dhe i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëditjet e ekspertëve dhe ekipit për takimet me qytetarë</li> <li>- Publikimi i rregullores në mediat lokale</li> <li>- Shtypja e katalogëve për rëndësinë e rregullores dhe ruajtjes së ambientit</li> <li>- Organizimi i aksioneve për mbrojtjen e mjedisit/gjatë muajit prill dhe qershor</li> <li>- Reklama dhe propaganda në mediat lokale</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783</b>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	2.000	1.000
	Qeveria qendrore	3.000	-
	Donatorët	3.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL (për vitin 2005)		8.000	1.000
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Gjashtëmuji i vitit 2006	

<b><u>Projekti 2</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Ripyllëzimi i pyjeve të djegura</u></b>		<b><u>Përmirësimi dhe mbrojtja e ambientit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Djegia e pyjeve në Kosovë është bërë një dukuri negative, e cila ka tendencë të rritjes. Sidomos pas luftës së fundit, kjo dukuri negative ka përfshirë edhe komunën e Gjilanit. Në vendin e quajtur "Zabeli i Sahit Agës", pas përfundimit të luftës, janë djegur disa qindra hektarë të pyjeve halore, po ashtu edhe rrëzë kodrës së Pasjakut ku gjendet edhe liqeni artificial i Livoçit. Këto dy vende janë pyllëzuar para 20-25 viteve me aksione vullnetare të rinisë së atëhershme. Mendojmë se edhe sot rinia e Gjilanit ka potencial të mjaftueshëm për të ndërmarrë aksione të tilla në interes të përmirësimit të ambientit ku jeton. Këto pyje për komunën tonë paraqesin fabrika të oksigjenit dhe filtra të ajrit të ndotur, ndërsa sot njerëz të pandërgjegjshëm i shkatërrojnë ato.</p> <p>Në projekt kërkojmë pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura në komunën tonë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Pjesa nga baseni afër fshatit Velekincë deri te fabrika e lëngjeve "Fluidi"</li> <li>o "Zabeli i Sahit Agës"</li> <li>o "Kodra e Pasjakut"</li> </ul> <p>Projekti do të realizohet në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Punësimit, e cila do të sigurojë punëtorët për implementimin e projektit, pasi qendra disponon me shënime të sakta mbi punëkërkesit në komunën tonë.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ta mbrojmë mjedisin jetësor nga deponitë e egra</li> <li>- Ta ruajmë shëndetin e fëmijëve dhe të gjithë qytetarëve</li> <li>- Vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtjen e ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit</li> <li>- TMK, SHPK dhe KFOR-i</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe ajo e Bujqësisë</li> <li>- TMK, SHPK, KFOR-i</li> <li>- Ekonomia e Pyjeve</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> <li>- Mekanizim</li> <li>- Sigurimi i fidaneve</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i sipërfaqeve të zhveshura</li> <li>- Ndhima e vazhdueshme nga TMK, SHPK dhe KFOR-i</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i OJQ-ve dhe i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e trullit, pastrimi i terrenit, Matja - shënimi i vendeve për mbjellje, Çmimi i fidaneve dhe sasia e fidaneve, Norma ditore për hapjen e gropave për mbjellje, Norma ditore për mbjelljen e fidaneve, Kompensimi për punët e përkohshme, Vlera furnizuese e veglave të punës</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	-	-
	Qeveria qendrore	14.200	-
	Donatorët	7.800	-
	TOTAL	22.000	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Gjashtëmuji i vitit 2007	

<b><u>Projekti 3</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Pastrimi i shtretërve të lumenjve</u></b>		<b><u>Përmirësimi dhe mbrojtja e ambientit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Ndotja e ambientit është problemi kryesor në komunën tonë, sidomos nga ujërat e zeza (kanalizimet). Në bazë të gjendjes ekzistuese të rrjetit të kanalizimit në Gjilan, si dhe lumenjve Dobrusha dhe Stanishorka në të cilët derdhen ujërat e zeza, shihet se brenda një periudhe të shkurtër do të kemi një krizë ekologjike në rajonin e lindjes. I tërë rrjeti i ujërave të zeza derdhet në lumin Morava, i cili ka një sasi shumë të vogël të ujit, gjë që e bën të pamundshëm pastërtinë e këtyre dy lumenjve, pra dominojnë ujërat e zeza, të cilat pa u filtruar apo neutralizuar derdhen drejtpërdrejt në lumin Morava. Problem kryesor është hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjve, prandaj kërkohet të pastrohen shtretërit e lumenjve: Dobrusha dhe Stanishorka në Gjilan, pastaj në fshatrat Čerrićë, Livoç, Malishevë, Miresh, Uglar, Pogragjë, Zhegër, Lladovë, si dhe pastrimi i pendës së Livoçit.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ta mbrojmë mjedisin jetësor nga deponitë e egra</li> <li>- Ta ruajmë shëndetin e fëmijëve dhe të gjithë qytetarëve</li> <li>- Vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtjen e ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe MPMS</li> <li>- TMK</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (Drejtorja e Shërbimeve Publike)</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe MPMS</li> <li>- TMK dhe donatorët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> <li>- Mekanizim</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i lumenjve dhe ekzistimi i deponive pranë tyre</li> <li>- Ndarja e buxhetit për participim në projekt</li> <li>- Ndihma e vazhdueshme nga TMK dhe KFOR-i</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e buxhetit</li> <li>Mosinteresimi i OJQ-ve dhe i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi dhe financimi i 50 punëtorëve fizikë nga Qendra Rajonale e Punësimit</li> <li>- Grumbullimi i mbeturinave</li> <li>- Transporti i mbeturinave deri në deponi</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet mjetëve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	-	-
	Qeveria qendrore	13.200	-
	Donatorët	13.200	-
TOTAL (për vitin 2005-2006)		26.400	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2005 -2006</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Muaji shtator i vitit 2006</li> </ul>	

<b>Projekti 4</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Eliminimi i të gjitha deponive ilegale në qytet</u></b>		<b><u>Menaxhimi eficient i mbeturinave</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Meqenëse viteve të fundit kemi një rritje numerike të banorëve në qytet, është rritur edhe numri i deponive të egra përreth qytetit tonë.</p> <p>Momentalisht në qytetin tonë, nga inspektorët për mbrojtjen e ambientit dhe inspektorët e infrastrukturës, janë evidentuar disa deponi të egra, të cilat rrezikojnë seriozisht ambientin dhe shëndetin e njeriut, si në lagjen Dheu i Bardhë (pjesa e rrugës "A. Presheva"), pastaj pjesa e Rrugës Qarkore, si dhe varrosja e një pjesë të deponisë së Pasjakut.</p> <p>Synim kryesor i realizimit të këtij projekti është që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ta mbrojmë mjedisin jetësor nga deponitë e egra,</li> <li>- ta ruajmë shëndetin e fëmijëve dhe të gjithë qytetarëve.</li> </ul> <p>Për mirëmbajtjen e pastërtisë kujdeset Departamenti i Shërbimeve Publike, të cilit i është ndarë fondi për këtë qëllim. Ky departament në kuadër të vetin ka kompaninë "Higjiena", e cila kujdeset për grumbullimin dhe bartjen e bërlogut nëpër ekonomitë familjare dhe objektet tjera afariste, do të thotë se kompania "Higjiena" ka për obligim t'ju sigurojë qytetarëve tonë shërbime të mjaftueshme, të qëndrueshme dhe cilësore, ndërsa qytetarët i kryejnë obligimet për shërbimet e kryera.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ta mbrojmë mjedisin jetësor nga deponitë e egra</li> <li>- Ta ruajmë shëndetin e fëmijëve dhe të gjithë qytetarëve</li> <li>- Vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtjen e ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe MPMS</li> <li>- TMK, Higjieno-teknika</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (Drejtorja e Shërbimeve Publike)</li> <li>- Donatorët dhe shoqatat lokale për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe MPMS</li> <li>- TMK dhe Higjieno-teknika</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> <li>- Mekanizim</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndarja e buxhetit për participim në projekt</li> <li>- Ndihma e vazhdueshme nga TMK-ja dhe KFOR-i</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i OJQ-ve dhe i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpallja e tenderit, Angazhimi i një kompanie</li> <li>- Grumbullimi i mbeturinave</li> <li>- Ngarkimi i mbeturinave dhe vendosja e shenjave: „Ndalohej hedhja e bërlogut“!</li> <li>- Transporti i mbeturinave deri në deponi</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	2.500	2.500
	Qeveria qendrore	9.800	-
	Donatorët	9.800	-
TOTAL		22.100	2.500
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2005-2006</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shtatori i vitit 2006</li> </ul>	

<b><u>Projekti 5</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Riciklimi i mbeturinave të grumbulluara</u></b>		<b><u>Menaxhimi eficient i mbeturinave</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Qëllimi i parësor i Kuvendit Komunal të Gjilanit, pas gjithë atyre problemeve që janë grumbulluar me dekada, është: eliminimi i pasojave të tërmetit, rregullimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme, si dhe inicimi i procesit të ruajtjes së ambientit/riciklimi i mbeturinave.</p> <p>Gjilani disponon me deponinë rajonale (deponia gjendet në fshatin Velekincë), e cila është financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim dhe është ndër më modernet në Ballkan.</p> <p>Qëllimi parësor i këtij projekti është që së pari të bëhet ndarja (klasifikimi) e mbeturinave dhe pastaj riciklimi i tyre.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ta mbrojmë mjedisin jetësor</li> <li>- Ta ruajmë shëndetin e fëmijëve dhe të gjithë qytetarëve</li> <li>- Krijimi i vendeve të reja të punës</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe MPMS</li> <li>- AER dhe donatorë të tjerë</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (Drejtorja e Shërbimeve Publike)</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe MPMS</li> <li>- AER dhe donatorë të tjerë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i deponisë dhe lokacionit për riciklimin e mbeturinave</li> <li>- Ndarja e buxhetit për participim në projekt</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i OJQ-ve dhe i qytetarëve</li> <li>- Mungesa e donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi i objektit për vendosjen e makinave për ta bërë riciklimin e mbeturinave</li> <li>- Sigurimi, pagesa, paketimi, transporti, garancioni nga blerësi për reklamim në rast të pengesave gjatë aktivizimit, dmth. pajisjeve të nevojshme që shërbejnë për riciklimin e mbeturinave</li> <li>- Montimi i makinave për riciklimin dhe përpunimin e mbeturinave</li> <li>- Trajnimi i stafit për punë</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	-	-
	Qeveria qendrore	140.000	-
	Donatorët	140.000	-
TOTAL		280.000	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006		- Tetori i vitit 2007	

<b>Projekti 6</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Hartimi i planit zhvillimor komunal</u></b>		<b><u>Hartimi i planeve komunale</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Qëllimi i këtij projekti ka të bëjë me hartimin e planit zhvillimor të komunës, i cili mbulon territorin e brendshëm të saj. Ky plan është një plan strategjik multisektoral, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Plani zhvillimor i komunës është plan i cili përfshin planin për zhvillim të zonave urbane dhe rurale brenda komunës. Plani zhvillimor i komunës hartohet për një periudhë 10-20 vjeçare. Për realizimin e këtyre detyrave, Kuvendi Komunal duhet të ketë përkushtim më të madh, në mënyrë që të krijojë një sistem të organizuar për menaxhim të tërësishëm të planit zhvillimor. Duke e parë rëndësinë e planeve zhvillimore komunale, si parakusht për implementimin e strategjisë zhvillimore "Delta II", komuna e Gjilanit ka ndarë nga buxheti vetjak mjete financiare në shumë prej 50.000 €. Kjo shumë është vetëm participim në realizimin dhe në implementimin e projektit, një pjesë e mjeteve kërkohet nga donatorët dhe qeveria qendrore, gjegjësisht ministritë përkatëse.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i kushteve për një shfrytëzim sa më racional të tokës</li> <li>- Mundësia e planifikimit edhe në zonat rurale</li> <li>- Krijimi i zonave të biznesit dhe zonave të gjelbëruara</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat e arkitektëve</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Amb. dhe Plan. Hap.</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor</li> <li>- Kuvendi Komunal</li> <li>- Ekipi komunal për planifikim</li> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Drejtoria për Pronë dhe Kadastër</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat e arkitektëve</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Amb. dhe Plan. Hapësinor</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i planit gjeneral të qytetit</li> <li>- Ekipi komunal për planifikim</li> <li>- Ekspertët kompetentë brenda dhe jashtë komunës</li> <li>- Ekzistimi i një konsensusi dhe zotimi i drejtorive për bashkëpunim</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mungesa e informatave reale</li> <li>- Mundësia që ndërmarrja e cila e harton - planin të bie nën ndikimin e grupeve të veçanta të interesit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja dhe shpallja e tenderit (në mediat e shkruara dhe në uebfaqen e internetit të komunës)</li> <li>- Shpenzimet e debatit publik me qytetarë</li> <li>- Implementimi i planit zhvillimor komunal</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	50.000	50.000
	Qeveria qendrore	60.000	-
	Donatorët	60.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		170.000	50.000
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Viti 2006 -2015	

<b>Projekti 7</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b>Hartimi i planit zhvillimor urban</b>		<b>Hartimi i planeve komunale</b>	
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>			
<p>Hartimi i planit zhvillimor urban është plan strategjik multisektorial, i cili përcakton synimet afatgjata për zhvillimin dhe menaxhimin e zonave urbane prej së paku 5 vitesh. Hartimi i planit zhvillimor urban duhet të jetë në pajtim me planin zhvillimor komunal. Plani zhvillimor urban duhet të bazohet në zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të zhvillimit hapësinor të zonave urbane dhe duhet të bazohet në qeverisje të mirë dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social, ekologjik dhe kulturor. Hartimi i planit zhvillimor urban bëhet nga parimi i interesit të përgjithshëm shoqëror, me qëllim të sigurimit të kushteve më të mira të banimit dhe jetës së qytetarëve. Implementimi i këtij plani është thelbësor, pasi që kjo do të ndikojë në mënyrë potenciale në ndalimin e ndërtimeve të egra, të cilat e kanë shëmtuar qytetin. Për realizimin e këtyre detyrave, Kuvendi Komunal duhet të ketë përkushtim më të madh, në mënyrë që të krijojë një sistem të organizuar për menaxhim të tërësishëm të planit zhvillimor. Duke e parë rëndësinë e planeve zhvillimore urbane, si parakusht për implementimin e strategjisë zhvillimore "Delta II", komuna e Gjilanit edhe për këtë projekt ka ndarë nga buxheti vetjak mjete financiare në shumë prej 50.000 €. Kjo shumë është vetëm participim në realizimin dhe në implementimin e projektit, një pjesë e mjeteve kërkohet nga donatorët dhe qeveria qendrore, gjegjësisht ministrinë përkatëse.</p>			
<b>Rezultatet e pritshme</b>		<b>Përfituesit</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i kushteve për një shfrytëzim sa më racional të tokës,</li> <li>- Mundësia e planifikimit edhe në zonat rurale</li> <li>- Krijimi i zonave të biznesit dhe zonave të gjelbëruara</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët, Shoqatat e arkitektëve, Shoqatat për mbrojtjen e ambientit, Ministria e Amb. dhe Plan. Hapësinor, Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b>Akterët e mundshëm</b>		<b>Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor</li> <li>- Kuvendi Komunal</li> <li>- Ekipi komunal për planifikim</li> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient</li> <li>- Drejtoria për Pronë dhe Kadastër</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqësit e projektit</li> <li>- Ekspertët lokalë ose të huaj të ofrojnë ekspertizë teknike në fushën e planifikimit</li> <li>- Bashkëfinancuesit e projektit</li> <li>- Studentët mund të ofrojnë shërbime teknike nën mbikëqyrjen e stafit profesional, në mënyrë që të fitojnë eksperiencë</li> </ul>	
<b>Parakushtet</b>		<b>Faktorët e rrezikut</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i planit gjeneral të qytetit, Ekzistimi i planit urbanistik,</li> <li>- Ekipi komunal për planifikim</li> <li>- Ekspertët kompetentë brenda dhe jashtë komunës</li> <li>- Ekzistimi i një konsensusi dhe zotimi i drejtorive për bashkëpunim</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit, Mungesa e informatave reale, Mundësia që ndërmarraja e cila e harton planin të bie nën ndikimin e grupeve të veçanta të interesit</li> </ul>	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja dhe shpallja e tenderit (në mediat e shkruara dhe në uebfaqen e internetit të komunës)</li> <li>- Shpenzimet e debatit publik me qytetarë, Implementimi i planit zhvillimor urban</li> </ul>			
<b>Organizimi i implementimit</b>		<b>Personi kontaktues:</b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</b>	<b>Burimet e financimit</b>	<b>Shuma e planifikuar</b>	<b>Shuma e siguruar</b>
	Qeveria lokale	50.000	50.000
	Qeveria qendrore	60.000	-
	Donatorët	60.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		170.000	50.000
<b>Koha e implementimit</b>		<b>Koha e ndikimit</b>	
- Brenda vitit 2005		Viti 2006 -2010	

<b><u>Projekti 8</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Hartimi i planeve rregullative</u></b>		<b><u>Hartimi i planeve komunale</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Me planet rregulluese urbane caktohen kushtet për rregullimin e hapësirës si dhe rregullat e lokacionit të objekteve dhe ngastrat (parcelat) tokësore urbane. Planet rregulluese urbane do të definojnë zonat e ndërtimit dhe do të përfshijnë linjat e rregullimit, linjat e ndërtimit, normat teknike urbanistike dhe kushtet tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave dhe ndërtimet tjera në ngastrat tokësore urbane. Për realizimin e këtyre detyrave, Kuvendi Komunal duhet të ketë përkushtim më të madh, në mënyrë që të krijojë një sistem të organizuar për menaxhim të tërësishëm të planit zhvillimor.</p> <p>Duke e parë rëndësinë e planeve rregullative urbane, si parakusht për implementimin e strategjisë zhvillimore "Delta II", komuna e Gjilanit ka ndarë nga buxheti vetjak mjete financiare në shumë prej 100.000 €. Kjo shumë është vetëm participim në realizimin dhe në implementimin e projektit, një pjesë e mjeteve kërkohet nga donatorët dhe qeveria qendrore gjegjësisht ministrinë përkatëse.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i kushteve për një shfrytëzim sa më reacional të tokës,</li> <li>- Mundësia e planifikimit edhe në zona rurale</li> <li>- Krijimi i zonave të biznesit dhe zonave të gjelbëruara</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat e arkitektëve</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Amb. dhe Plan. Hapësinor</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor</li> <li>- Kuvendi Komunal</li> <li>- Ekipi komunal për planifikim</li> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Drejtoria për Urbanizëm, Rindërtim dhe Ambient</li> <li>- Drejtoria për Pronë dhe Kadastër</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqësit e projektit</li> <li>- Ekspertët lokalë ose të huaj të ofrojnë ekspertizë teknike në fushën e planifikimit</li> <li>- Bashkëfinancuesit e projektit</li> <li>- Studentët mund të ofrojnë shërbime teknike nën mbikëqyrjen e stafit profesional, në mënyrë që të fitojnë eksperiencë</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i planit gjeneral të qytetit</li> <li>- Ekzistimi i planit urbanistik</li> <li>- Ekipi komunal për planifikim</li> <li>- Ekspertët kompetentë brenda dhe jashtë komunës</li> <li>- Ekzistimi i një konsensusi dhe zotimi i drejtorive për bashkëpunim</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mungesa e informatave reale</li> <li>- Mundësia që ndërmarrja e cila e harton planin të bie nën ndikimin e grupeve të veçanta të interesit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja dhe shpallja e tenderit (në mediat e shkruara dhe në uebfaqen e internetit të komunës)</li> <li>- Shpenzimet e debatit publik me qytetarë</li> <li>- Implementimi i planit zhvillimor komunal</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	100.000	100.000
	Qeveria qendrore	60.000	-
	Donatorët	60.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		220.000	100.000
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Viti 2006 -2015	

<b><u>Projekti 9</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Ndërtimi i kapaciteteve të inspektorëve të ndërtimit për të penguar ndërtimet ilegale</u></b>		<b><u>Hartimi i planeve komunale</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Administrata Komunale në Gjilan funksionon pandërprerë afër gjashtë dekada, me një të kaluar herë të hidhur dhe shumë të vështirë, e herë të përcjellë edhe me diferencime politike por, megjithatë, ka bërë një organizim të jetës në suaza të një normaleje. Organizimi i ri dhe rrënjësor i administratave komunale, me një hierarki më demokratike dhe më euroriane dhe me krijimin e departamenteve të reja, bëri që të mbulohej të gjitha nevojat apo shërbimet që i mungonin komunës sonë, mirëpo shkëmbimi i përvojave apo i eksperiencave me vendet që më herët kanë filluar fazën e tranzicionit si Sllovenia e Kroacia, do të jetë i domosdoshëm, sepse me këmbimin e përvojave do t'i ngrisim dhe forcojmë organet tona komunale, njëherit do t'i mbulojmë ato zbrazëtira që për momentin ekzistojnë.</p> <p>Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë Ligjin e Inspektoriatit. Është i nevojshëm shkëmbimi i përvojave me vendet në tranzicion apo mbajtja e seminareve (trajtimeve) për shërbimin e inspektorëve të ndërtimit. Ky shërbim i inspeksionit të ndërtimit do të njoftohet edhe me ligje të tjera siç është ligji i ndërtimit, që ka shumë rëndësi për komunën e Gjilanit, pasi që gjendet në zonën seizmike (dridhja e tokës), andaj ndërtimet ilegale janë rreptësisht të ndaluara.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i kushteve për ndalimin e ndërtimeve pa leje</li> <li>- Bashkëpunimi më i mirë me qytetarë (shërbimi i inspektorëve të ndërtimit-qytetarët)</li> <li>- Njohja me rregulloret e reja dhe shkëmbimi i përvojave me vendet të cilat kanë kaluar këtë fazë të tranzicionit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (Shërbimi i Inspeksionit)</li> <li>- Shoqatat - byrotë projektuese</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe Planifikimit</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat - byrotë projektuese</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe Planifikimit</li> <li>- Donatorët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i ligjit të ndërtimit</li> <li>- Ekzistimi i shumë byrove projektuese</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i qytetarëve</li> <li>- Mosparticipimi i komunitetit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpenzimet e organizimit të trajnimit</li> <li>- Shpenzimet e angazhimit të ligjëruesve</li> <li>- Shpenzimet e udhëtimit në një nga vendet në tranzicion (Slloveni, Kroaci, Bullgari, Maqedoni, Shqipëri)</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	3.000	-
	Qeveria qendrore	6.000	-
	Donatorët	6.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		15.000	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006		- Shtatori i vitit 2007	

<b>Projekti 10</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat urbane</u></b>		<b><u>Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Me sistemin e kanalizimit të ujërave fekale është i mbuluar vetëm qyteti i Gjilanit dhe atë jo në tërësi. Gjendja e rrjetit të kanalizimit të ujërave fekale është shumë e keqe, pasi që vjetërsia e tij është shumë e madhe (mbi 20 vjet e diku edhe mbi 30 vjet i vjetër), dhe në një gjatësi mjaft të madhe një pjesë e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike është i kyçur në atë të ujërave fekale, me ç'rast sasia e ujërave të ndotura (të përzier fekal-atmosferik) rritet shumë dhe të njëjtit derdhen në lum. Për këtë arsye, primare për administratën komunale është që, brenda mundësive maksimale të buxhetit dhe investimeve të huaja nga donatorët, të përmirësohet infrastruktura komunale, në radhë të parë të rregullohen rrjetet e kanalizimeve (ujërave të zeza) dhe rrjetet e ujësjellësit, për arsye se vazhdimisht sjellin probleme të shumta dhe sëmundje të ndryshme infektive, ku më së shumti po pësojnë fëmijët dhe banorët e komunës sonë, sidomos në zonat urbane (lagjet Dheu i Bardhë, Arbëria, Ramiz Cërrnica, Zabeli i Sahit Agës etj.) Po ashtu, për furnizim me ujë të pijshëm duhet të parashihet edhe ndërtimi i rezervuarit të ujit të pijshëm për nevoja të qytetit, që parashihet të ndërtohet në lokacionin Kodra e Dëshmorëve, prej ku do të furnizohen të gjitha pjesët e qytetit me ujë të pijshëm. Rrjeti i kanalizimit, po ashtu, duhet të zgjerohet edhe në zonat e reja urbane.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Do të mbrohet shëndeti i fëmijëve dhe banorëve dhe do të krijohen kushte më të mira për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (departamentet përgjegjëse)</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i rregullores së aprovuar</li> <li>- Ekzistimi i shumë OJQ-ve lokale të ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit, Mosinteresimi i qytetarëve, Mosparticipimi i komunitetit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Ndërtimi i rezervuarit të ujit për nevojat e qytetit, gërmimi i kanalit me eskavator me dimensione h=1.2; b=0.8, furnizimi, transporti dhe shtruarja e shtresës së rërës si shtresë tamponi me trashësi t=10cm, furnizimi, transporti dhe mbulimi i gypit me rërë me trashësi t=20cm, furnizimi, transporti dhe montimi i gypave me të gjitha pjesët përcjellëse, rregullimi i shtratit të lumenjve (Dobrusha dhe Stanishorka) dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit në dy anët, përgjatë shtratit të lumenjve me gypa <math>\Phi = 1000</math></p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	985.000	150.000
	Qeveria qendrore	850.000	-
	Donatorët	850.000	
	Iniciativa të tjera	-	
TOTAL (viti 2005,2006,2007)	2.685.000	150.000	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005 – 2007		- Gjashtëmuji i vitit 2007	

<b>Projekti 11</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit në zonat rurale</u></b>		<b><u>Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Në bazë të gjendjes ekzistuese të rrjetit të kanalizimit shihet që brenda një periudhe të shkurtër do të kemi një krizë ekologjike në fshatrat e komunës sonë. Po ashtu, edhe investimet në rrjetin e ujësjellësit janë shumë të domosdoshme. Andaj, primare për administratën komunale është që, brenda mundësive maksimale të buxhetit dhe investimeve të huaja të organizatave qeveritare dhe joqeveritare, të përmirësohet gjendja e ujësjellësit, përmirësimi i ambientit, rregullimi i rrjeteve të kanalizimit dhe neutralizimi i ujërave të zeza, etj., sidomos në viset rurale. - Faza e parë e rregullimit të kanalizimit dhe ujësjellësit do të përfshijë këto lokalitete: Livoçin e Poshtëm, Malishevën e Epërme, deri te Kufca e Ulët, pastaj Koretishtën dhe Pasjakun dhe Velekincën dhe Pasjanin. Faza e dytë do të përfshijë Zhegrën, Lladovën dhe Budrikën, pastaj Cërrnicën, Vërbicën e Kmetocit dhe Kmetocin, si dhe Bresalcin, Poneshin, Uglarin, Pogragjiën, Bilincën dhe Mireshin.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Do të mbrohet shëndeti i fëmijëve dhe banorëve dhe do të krijohen kushte më të mira për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme</li> <li>- Faza I (viti 2005 -2006): në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit do të përfshihen Malisheva, Kufca e Ulët, Velekinca, Pasjani, Koretisha dhe Pasjaku dhe Livoçi i Poshtëm</li> <li>- Faza II (2006 -2007): në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit do të përfshihen Zhegra, Lladova, Budrika, Parteshi, Bresalci, Pogragja etj.</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (departamentet përgjegjëse)</li> <li>- Shoqatat për mbrojtjen e ambientit</li> <li>- Ministria e Ambientit</li> <li>- Donatorët (organizatat ndërkombëtare)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i rregullores së aprovuar</li> <li>- Ekzistimi i shumë OJQ-ve lokale të ambientit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit, Mosinteresimi i qytetarëve, Mosparticipimi i komunitetit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Hapja e puseve (shpuarja), ndërtimi i rezervuarit të ujit me kapacitet të mjaftueshëm dhe ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza, gërmimi i kanalit me eskavator me dimensione h=1.2; b=0.8, furnizimi, transporti dhe shtruarja e shtresës së rërës si shtresë tamponi me trashësi t=10cm, furnizimi, transporti dhe mbulimi i gypit me rërë me trashësi t=20cm, furnizimi, transporti dhe montimi i gypave me të gjitha pjesët përcjellëse, ndërtimi i kolektorëve për ujërat e zeza nëpër çdo lokalitet dhe ndërtimi i kolektorit të qytetit për neutralizimin e ujërave të zeza para derdhjes në lumin Morava (afër fshatit Uglar).</p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	850.000	70.000
	Qeveria qendrore	750.000	-
	Donatorët	750.000	
	Iniciativa të tjera	210.000	
TOTAL (viti 2005, 2006, 2007)		2.560.000	70.000
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2005, 2006, 2007</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tetori i vitit 2007</li> </ul>	

<b>Projekti 12</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Ndërtimi i sistemit të ujitjes përgjatë lumit Morava</u></b>		<b><u>Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit/kanalizimit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Komuna e Gjilanit, me një relief mjaft heterogjen dhe me një klimë të mesme kontinentale, ofron kushte të mira për zhvillimin e bujqësisë, përkatësisht degëve të saj: lavëtarisë dhe blegtorisë. Vlerësohet se në etapa të ndryshme mëse 60% e popullsisë së Gjilanit me rrethinë, është marrë me bujqësi dhe jorastësisht qyteti njihet si agroindustrial. Qyteti ka një sipërfaqe prej 515 km<sup>2</sup> dhe shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës dhe vlerësohet se ka rreth 14,200 ha tokë të punueshme, mbi 20,000 ha pyje dhe kullosa dhe 13,550 ha tokë pasive. Mungesa e ujit të bollshëm sot ka ndikuar drejtpërdrejtë në orientimin e bujqve për kultivimin e kulturave të pakta, prandaj si pasojë e thatësirave është paraparë se duhet investuar në sistemin e ujitjes, që do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në kultivimin e kulturave të bollshme, sidomos bimëve industriale si duhani, luledielli etj. Nga projekti i ndërtimit të ujitjes përgjatë lumit Morava përfshihen këto lokalitete: Zhegër, Lladovë, Nasalë, Partesh, Budrikë e Ulët, Pasjan, Llashticë, Velekincë, Livoç i Ulët dhe Malishevë. Projekti mendohet të realizohet me ujitje të ashtuquajtur sisteme të mëdha, sisteme me të cilat mund të përfshihen disa qindra ose mijëra hektarë tokë të punueshme, ku bëhet ujitja kolektive e organizuar me rend dhe sasi të caktuara të ujitjes.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e rendimenteve së paku për 30-40 %</li> <li>- Shfrytëzimi i dy e më tepër kulturave brenda një sezoni vegjetativ,</li> <li>- Kalimi nga prodhimtaria ekstensive në atë intensive,</li> <li>- Integrimi i komuniteteve, dhe</li> <li>- Krijimi i vendeve të reja të punës</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët (bujqit)</li> <li>- Shoqatat për zhvillimin e bujqësisë</li> <li>- Ministria e Bujqësisë</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve (bujqit)</li> <li>- Donatorë të ndryshëm</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (departamentet gjegjëse)</li> <li>- Shoqatat për zhvillimin e bujqësisë</li> <li>- Ministria e Bujqësisë</li> <li>- Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsiror</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gatishmëria e komunës (drejtoritë përgjegjëse)</li> <li>- Ekzistimi i shumë OJQ-ve lokale për zhvillimin e bujqësisë,</li> <li>- Gatishmëria e bujqve lokalë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i OJQ-ve dhe i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e projektit detal-teknik për implementim,</li> <li>- Caktimi i fshatrave për fazën e parë të kyçjes në sistemin e ujësjellësit,</li> <li>- Participimi i bujqve në realizimin e projektit,</li> <li>- Implementimi i projektit</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni- tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	16.000	-
	Qeveria qendrore	85.000	-
	Donatorët	85.000	-
	Iniciativa të tjera	16.000	-
TOTAL		202.000	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2005, 2006</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjashtëmuji i vitit 2007</li> </ul>	

<b><u>Projekti 13</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonat urbane</u></b>		<b><u>Ndërtimi/zgjerimi i rrjetit rrugor dhe të telekomunikacionit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Nga rrethanat e krijuara në dekadën e fundit të këtij shekulli, ne kemi trashëguar një infrastrukturë të papërshtatshme dhe të kufizuar, si dhe një shkallë të lartë të amortizimit, andaj primare për administratën komunale është që brenda mundësive maksimale të buxhetit dhe investimeve të huaja të organizatave qeveritare dhe joqeveritare të përmirësohet gjendja e rrugëve në zonat urbane. Investimet në zonat urbane, sidomos të rregullimit të rrugëve, krijojnë lehtësira për ndërmarrjet që janë aktive dhe vetvetiu krijojnë mundësi edhe për biznese të reja. Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonat urbane përfshin lagjen nr.8 (Ramiz Çërnica) pastaj pjesën e lagjes Arbëria (rrugët që lidhen me shkollën "A. Ajeti", pjesën deri afër fshatit Velekincë, pjesën e rrugës së Prishtinës dhe pjesën e rrugës për Livoçin e Epërm, ndërsa për riparim (dhe një pjesë asfaltim) është lagjja Dardania I dhe II, po ashtu në riparim dhe asfaltim duhet të përfshihet edhe lagjja Dheu i Bardhë (pjesa "A. Presheva"). Në asfaltimin e rrugëve do të përfshihet edhe rruga nga Çesma e Malishevës – lagjja Zabeli i Sahit Agës, e cila do të lidhet me rrugën Gjilan-Preshevë.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Efikasiteti i qarkullimit të qytetarëve dhe i mallit, si dhe arritja me kohë më të shpejtë në qendrën spitalore</li> <li>- Do të krijohen kushte më të mira për banorët e dy lagjeve, të cilët duhen të kalojnë disa kilometra rrugë për të dalur në lagjen tjetër</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Donatorët (organizatat ndërkombëtare)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit dhe bashkëfinancues</li> <li>- Asistencë teknike dhe bashkëfinancim</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i fondit për participim në projekt</li> <li>- Ekzistimi i komunitetit për përkrahje dhe participim</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i komunitetit për participim</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Mihja e gjerë e dheut me buldozer tg-200, ngjeshja e trupit të rrugës me cilindër, furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0.31.5mm d=10cm, furnizimi, transporti dhe ngjeshja e bito-zhavorit d=6 cm, furnizimi, transporti dhe ngjeshja e asfalt-betonit d=3 cm, ngritja e shahteve të kanalizimit dhe ujësjellësit në vendet e duhura.</p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	730.000	130.000
	Qeveria qendrore	650.000	-
	Donatorët	650.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL (vitet 2005, 2006, 2007)		2.030.000	130.000
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit:</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2005, 2006, 2007</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tetori i vitit 2007</li> </ul>	

<b><u>Projekti 14</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve të reja në rajonet rurale</u></b>		<b><u>Ndërtimi/zgjerimi i rrjetit rrugor dhe të telekomunikacionit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Edhe pse, me angazhimin e strukturave komunale, në masë të madhe janë zvogëluar problemet e trashëguara nga e kaluara, ende mbetet shumë për t'u bërë, sidomos në infrastrukturën rrugore. Ky projekt ka për qëllim ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve të reja në zonat rurale, të cilat janë të papërshtatshme për qarkullim. Rregullimi i rrugëve dhe asfaltimi përfshin këto lokalitetet: Përlepnica (rruga deri në fshat) Mireshi, Zhegra, rruga Pogragjë-Dobrosin, pastaj rruga Sllubicë-Llovcë, rruga e Bilinicës, rruga e Poneshit, pjesa e paasfaltuar, rruga për Kravaricë dhe Gumnishtë. Ndërsa, rrugët të cilat kanë nevojë për zgjerim dhe mbushje në zonat më malore të komunës sonë janë: Malësia e Sllubicës (Iagjja e Zahirëve), Malësia e Buricës, Lipovicës, Muçibabës, pjesa e Malësisë së Zhegrës, Sllakocit dhe pjesa e Malësisë së Makreshit.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Do ta ndalnim shpërnguljen e fshatarëve drejt qytetit, pra do të ndalohet migrimi fshat-qytet</li> <li>- Efikasiteti i qarkullimit të qytetarëve dhe i mallit</li> <li>- Arritja me kohë dhe më shpejt në qendrën spitalore</li> <li>- Intervenimi më i shpejtë në raste urgjente</li> <li>- Lidhjet më të mira/shkurtëra me fshatrat dhe qytetet tjera</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Donatorët (organizatat ndërkombëtare)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit dhe bashkëfinancues</li> <li>- Asistencë teknike dhe bashkëfinancim</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i fondit për participim në projekt</li> <li>- Ekzistimi i komunitetit për mundësinë e participimit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i qytetarëve</li> <li>- Mosparticipimi i komunitetit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Për asfaltim: Mihja e gjerë e dheut me buldozer tg-200, ngjeshja e trupit të rrugës me cilindër, furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0.31.5mm d=10cm, furnizimi, transporti dhe ngjeshja e bito-zhavorit d=6 cm, furnizimi, transporti dhe ngjeshja e asfalt-betonit d=3 cm, ngritja e shahteve të kanalizimit dhe ujësjellësit.</p> <p>Për zgjerim dhe mbushje me zhavor: Mihja e gjerë e tokës dhe rrafshimi i të njëjtës me eskavator, mbushja e trasesë me zhavor steril (shterpë) dhe rrafshimi i të njëjtës me eskavator në trashësi d=30 cm, vendosja e tubave për largimin e ujërave atmosferike:Φ – 500 / Φ – 1000 apo ndërtimi i urave të vogla.</p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	560.000	150.000
	Qeveria qendrore	420.000	-
	Donatorët	420.000	-
	Iniciativa të tjera	80.000	-
TOTAL		1.480.000	150.000
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005, 2006, 2007		- Tetori i vitit 2007	

<b>Projekti 15</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Përmirësimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat urbane</u></b>		<b><u>Ndërtimi/zgjerimi i rrjetit rrugor dhe të telekomunikacionit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
Edhe pse, me angazhimin e strukturave komunale, në masë të madhe janë zvogëluar probleme të shumta, megjithatë detyrë me rëndësi është edhe përmirësimi i rrjetit të telekomunikacionit në tërë qytetin. Për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të telekomunikacionit në komunën tonë ekziston PTK, e cila kujdeset për shërbimin e telefonisë, do të thotë se ka obligim t'ju sigurojë qytetarëve tanë shërbime të mjaftueshme, të qëndrueshme dhe cilësore. Përmirësimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat urbane duhet të përfshijë lagjen nr. 8 -Ramiz Cërrnica, Arbëria, Dardania I dhe II, lagjja Dheu i Bardhë, pjesa e Qarkores dhe Zabeli, pjesa e re e ndërtuar.			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Efikasiteti i komunikimit me qendrat tjera</li> <li>- Mundësia e kyçjes në rrjetin e internetit</li> <li>- Mundësia e komunikimit me të afërmit në diasporë</li> <li>-</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit / PTK</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit dhe bashkëfinancues</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i rrjetit urban të telefonisë fikse</li> <li>- Interesimi i komunitetit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapja e tenderit dhe caktimi i lagjeve për zgjerim të rrjetit të telefonisë</li> <li>- Përgatitja e projektit teknik-ekzekutues</li> <li>- Implementimi i projektit</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b>	
		Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	-	-
	Qeveria qendrore	250.000	-
	Donatorët	130.000	-
	Iniciativa të tjera	230.000	-
TOTAL		610.000	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2005, 2006, 2007</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjashtëmujori i vitit 2008</li> </ul>	

<b><u>Projekti 16</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat rurale</u></b>		<b><u>Ndërtimi/zgjerimi i rrjetit rrugor dhe të telekomunikacionit</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit në zonat rurale do të krijonte kushte të mira për qytetarët, për arsye se do të jenë më afër informatave dhe qasjes direkte me më të afërmit e tyre. Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit rural duhet të kalojë nëpër disa faza. Kështu, në fazën e parë përfshihen këto lokalitete: Velekinca, Pasjani, Llashtica, Zhegra, Lladova, Budrika dhe fshati Zhegër. Në këto lokalitete ka ekzistuar edhe më herët rrjeti i telefonisë fikse dhe numri i përfituesve të këtyre lokaliteteve llogaritet të jetë mbi 20.000 banorë.</p> <p>Ndërsa, në fazën e dytë duhet të përfshihen Pasjaku, Poneshi dhe Bresalci. Në fazën e tretë përfshihet Pogragja dhe disa lokalitet në të cilat tashmë ekziston rrjeti i telefonisë fikse, si në Mireshe, Kmetoc, pastaj në Malishevë, Uglar etj. Në fazat tjera do të përfshihen edhe zonat më të larta kodrinoro-malore, si Malësia e Karadakut, e Zhegovcit etj. Po ashtu, në kuadër të zgjerimit të telekomunikacionit, duhet të përfshihet edhe vendosja e repetitorëve në fshatrat Pogragjë, Cërnice dhe Bresalc, sepse në këto lokalitet mungon edhe sinjali (shikueshmëria e kanaleve televizive vendore), si dhe mungon edhe qasja e telefonisë mobile Vala 900, për shkak të pozitës gjeografike të lokaliteteve. Po ashtu, në kuadër të këtij projekti duhet të përfshihet edhe asfaltimi i rrugës Kosaq-Maja e Gjelbër, ku janë të vendosur të gjithë repetitorët që e mbulojnë komunën e Gjilanit, qoftë me rrjet të telefonisë mobile apo të televizioneve nacionale, prandaj asfaltimi i rrugës do të krijonte kushte të mira dhe qasje në çdo kohë në rast të prishjeve dhe problemeve të tjera.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Efikasiteti i komunikimit me qendrat tjera</li> <li>- Mundësia e kyçjes në rrjetin e internetit</li> <li>- Mundësia e komunikimit me të afërmit në diasporë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Organizatat joqeveritare lokale</li> <li>- Ministria e Transportit / PTK</li> <li>- Donatorët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit dhe bashkëfinancues</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i fondit për participim në projekt</li> <li>- Ekzistimi i komunitetit për mundësinë e participimit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i qytetarëve</li> <li>- Mosparticipimi i komunitetit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapja e tenderit dhe caktimi i lagjeve për zgjerim të rrjetit të telefonisë</li> <li>- Përgatitja e projektit teknik-ekzekutues</li> <li>- Implementimi i projektit</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	-	-
	Qeveria qendrore /PTK	850.000	-
	Donatorët	370.000	-
	Iniciativa të tjera		
TOTAL		1.220.000	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2005, 2006,2007</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjashtëmujori i vitit 2007</li> </ul>	

<b>Projekti 17</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Themelimi i trupës komunale për koordinim ndërkufitar</u></b>		<b><u>Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar</u></b>	
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>			
<p>Komuna e Gjilanit është pjesë e bashkëpunimit ndërkufitar që nga viti 2002, kur është nënshkruar edhe memorandum i mirëkuptimit dhe, që nga ky moment, komunat Kumanovë (Maqedoni) – Preshevë dhe Tërgovishtë (Serbi) – Gjilan (Kosovë) kanë intensifikuar bashkëpunimin ndërkufitar dhe ky program i inkurajuar edhe nga Këshilli i Evropës dhe Pakti i Stabilitetit po thellohet gjithnjë e më shumë, pasi që kryetarët e këtyre komunave iu kanë hapur rrugë proceseve të reja integruese në rajon. Kur është hedhur kjo ide e mikrorajonit, askush nuk besonte se shqiptarët, serbët dhe maqedonasit mund të bashkëpunonin ndërmjet tyre, sepse Maqedonia ende ndodhej në konflikt të armatosur, Lugina e Preshevës sapo kishte dalur nga konflikti, ndërsa pak vite kishin kaluar nga lufta në Kosovë. Gjatë takimit të kryetarëve, ishin të mendimit se duhet të formohen grupet punuese brenda komunave për jetësimin e kësaj marrëveshjeje dhe sot funksionojnë këto grupe punuese (GP), të cilët janë të ndara në tri sektore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. GP në Kulturë, Arsim, Rini, Sport, Media, Çështje Gjinore dhe OJQ lokale</li> <li>2. GP në Zhvillim Ekonomik dhe Agrokulturë</li> <li>3. GP në Infrastrukturë, Shërbime Publike dhe Ambient</li> </ol> <p>Po ashtu, komuna e Gjilanit, me angazhimin e saj, ka arritur të njihet si qytet që kultivon tolerancën ndëretnike në këtë pjesë të Ballkanit. Si komunë kufitare, ne jemi duke punuar edhe në Programin e Pajtitimit dhe Bashkëpunimit Ndërkufitar Gjilan-Kumanovë-programi financohet nga USAID-i, ndërsa implementohet nga Catholic Relief Services - CRS. Trupa komunale për bashkëpunim ndërkufitar është e themeluar dhe funksionon me mbështetjen e vazhdueshme të kryetarit të komunës, kryeshefit ekzekutiv, Bordit të Drejtorëve dhe organizatave të cilat kanë shprehur interesim për avancimin e këtij projekti, si Instituti Lindje-Perëndim, USAID (CRS), Këshilli i Evropës, SIDA Suedeze, UNDP etj.</p>			
<b>Rezultatet e pritshme</b>		<b>Përfituesit</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i lehtësirave për qarkullimin e mallrave dhe njerëzve</li> <li>- Krijimi i pikave të reja kufitare</li> <li>- Krijimi i urave të bashkëpunimit mes të gjitha komuniteteve</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat lokale të mikrorajonit GPKT</li> </ul>	
<b>Akterët e mundshëm</b>		<b>Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale dhe mediat lokale</li> <li>- Shoqatat lokale të mikrorajonit GPKT</li> <li>- Ministrinë përkatëse</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare / KE, BE, EWI, ESI, CRS</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b>Parakushtet</b>		<b>Faktorët e rrezikut</b>	
<p>Ekzistimi i MEMO-s për bashkëpunim GPKT, Mbështetja e kryetarëve të komunave, Mbështetja e OJQ-ve lokale të mikrorajonit</p>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve për mbështetjen</li> </ul>	
<b>Shpenzimet e logaritura</b>			
<p>Shpenzimet e udhëtimeve për pjesëmarrësit e caktuar zyrtarë komunalë në aktivitetet e GPKT-së, shpenzimet e komunikimit, të ndërlidhura dhe shpenzimet për zyrë, shpenzimet për përkthim të ndërlidhura për përgatitje, kur paraqitet nevoja, të materialeve për projekte të tilla, si korrespondenca etj. Organizimi i takimeve (konferencave) me donatorë për përkrahjen e projekteve ndërkufitare</p>			
<b>Organizimi i implementimit</b>		<b>Personi kontaktues:</b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b>Shpenzimet e logaritura (burimet mjeteve)</b>	<b>Burimet e financimit</b>	<b>Shuma e planifikuar</b>	<b>Shuma e siguruar</b>
	Qeveria lokale	2.000	800
	Qeveria qendrore	9.000	-
	Donatorët	10.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
	<b>TOTAL</b>	<b>21.000</b>	<b>800</b>
<b>Koha e implementimit</b> Brenda vitit 2006, 2007		<b>Koha e ndikimit</b> Tetori i vitit 2007	

<b>Projekti 18</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b>Organizimi i panairit ndërkufitar</b>		<b>Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar</b>	
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>			
<p>Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar, komuna e Gjilanit planifikon edhe organizimin e një panairi ndërkufitar (Mikrorajonit GPKT / Gjilan-Preshevë-Kumanovë-Tërgovishte), në të cilin bëhet promovimi i produkteve vendore. Panairi ka karakter ndërkombëtar dhe shpresojmë se do të jetë tradicional. Për ekspozim janë siguruar 59 vende (stenda) brenda në sallën e sporteve, si dhe 10 të tjera në natyrë të hapur rreth sallës së sporteve. Në këtë panair do të ketë pjesëmarrës edhe nga rajoni (Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Bullgari dhe Serbi), por në një masë më të vogël.</p>			
<b>Rezultatet e pritshme</b>		<b>Përfituesit</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja e produkteve (prodhimeve) të mikrorajonit</li> <li>- Rritja e eksportit të ekonomisë lokale (mikrorajonit)</li> <li>- Kçyca e mëse 90% të bizneseve në panair</li> <li>- Promovimi i produkteve vendore, njohja - rritja e eksportit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat e biznesit</li> <li>- Oda ekonomike</li> <li>- Biznesmenët lokalë</li> </ul>	
<b>Akterët e mundshëm</b>		<b>Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale dhe mediat lokale</li> <li>- Shoqatat lokale të mikrorajonit GPKT</li> <li>- Ministrinë përkatëse</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare / KE, BE, EWU, ESI, CRS, inSar</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b>Parakushtet</b>		<b>Faktorët e rrezikut</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i MEMO-s për bashkëpunim GPKT</li> <li>- Mbështetja e kryetarëve të komunave</li> <li>- Mbështetja e OJQ-ve lokale të mikrorajonit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve për mbështetje</li> </ul>	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>			
<p>Shpenzimet e informimit të komunitetit të biznesit, organizimi i takimeve me biznesmenë prodhues në mikrorajon, organizimi i takimeve me shoqata të biznesit, përgatitja e listës së pjesëmarrësve dhe shpërndarja e ftesave, përgatitja e hapësirës për panair, sigurimi dhe montimi i stendave, sigurimi i mediave gjatë mbajtjes së panairit, mbajtja e konferencës gjatë promovimit të prodhimeve para mediave, përgatitja dhe shpërndarja e broshurave, anketimi i pjesëmarrësve për rezultatet e panairit, sigurimi i objektivit, përkthimi në gjuhët e mikrorajonit.</p>			
<b>Organizimi i implementimit</b>		<b>Personi kontaktues:</b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</b>	<b>Burimet e financimit</b>	<b>Shuma e planifikuar</b>	<b>Shuma e siguruar</b>
	Qeveria lokale	5.000	-
	Qeveria qendrore	7.500	-
	Donatorët	9.500	-
	Iniciativa të tjera	3.500	-
TOTAL		25.500	
<b>Koha e implementimit</b>		<b>Koha e ndikimit</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Brenda vitit 2006, 2007</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tetori i vitit 2007</li> </ul>	

<b>Projekti 19</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Organizimi i konferencës së donatorëve për financim të projekteve ndërkufitare</u></b>		<b><u>Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Duke pasur parasysh faktin se komuna e Gjilanit është pjesë përbërëse e bashkëpunimit ndërkufitar, Kuvendi Komunal parasheh mundësinë e organizimit të një konference ndërkombëtare me donatorët për mbështetjen e projekteve të mikrorajonit. Prioritetet e komunave të mikrorajonit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- krijimi i lehtësirave për kalimin e njerëzve dhe mallrave</li> <li>- hapja e pikave të reja kufitare / prioritet i komunës së Gjilanit është ndërtimi i rrugës Gjilan (Kosovë) - Kumanovë (Magedoni)</li> </ul>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohja me projektet e mikrorajonit</li> <li>- Njohja me problemet e mikrorajonit GPKT</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Shoqatat e biznesit dhe OJQ-të ndërkombëtare</li> <li>- Oda Ekonomike</li> <li>- Biznesmenët lokalë</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale dhe mediat lokale</li> <li>- Shoqatat lokale të mikrorajonit GPKT</li> <li>- Qeveria e Kosovës - ministritë përkatëse</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare / KE, BE, EWl, ESI, CRS, inSar</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i MEMO-s për bashkëpunim GPKT</li> <li>- Mbështetja e kryetarëve të komunave</li> <li>- Mbështetja e OJQ-ve lokale të mikrorajonit</li> <li>- Interesimi i organizatave ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve për mbështetje</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Shpenzimet e informimit të organizatave ndërkombëtare, organizimi i takimeve me OJQ-të, organizimi i takimeve me shoqata të biznesit, përgatitja e listës së pjesëmarrësve dhe shpërndarja e ftesave për donatorë, përgatitja e hapësirës për konferencë, sigurimi i mediave gjatë mbajtjes së konferencës, mbajtja e konferencës për media, përgatitja dhe shpërndarja e broshurave, anketimi i pjesëmarrësve për rezultatet e konferencës-panairit, përkthimi në gjuhët e mikrorajonit dhe në gjuhën angleze, vizitë rrugës Gjilan-Stançiq</p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	2.500	-
	Qeveria qendrore	2.500	-
	Donatorët	1.400	-
	Iniciativa të tjera	-	-
	TOTAL	6.400	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Tetori i vitit 2006	

<b><u>Projekti 20</u></b> <b><u>Kryerja e punimeve në rrugën Gjilan-Stançiq-Kumanovë</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b> <b><u>Infrastruktura rrugore për komunikim më të mirë ndërkufitar dhe ndërkomunal</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b> <p>Pasi që në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar, prioriteti i komunës së Gjilanit është ndërtimi i rrugës Gjilan (Kosovë) - Kumanovë (Maqedoni), atëherë Kuvendi Komunal i Gjilanit parasheh edhe nevojën e meremtit të kësaj rruge, e cila duhet të kalojë nëpër disa faza.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rruga Gjilan-Zhegër, e asfaltuar më herët por e amortizuar (prek lokalitetet Livoç, Budrikë, Lladovë, Zhegër),</li> <li>- Pjesa Zhegër-Shurdhan, e ndërtuar në vitin 2004, si dhe</li> <li>- Pjesa Shurdhan-Stançiq, e projektuar por e pakalueshme, andaj nevojitet asfaltimi i saj.</li> </ul>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Do të krijohen vende të reja të punës, gjë që ka shumë rëndësi (bujqësia)</li> <li>- Kontrollimi i mallrave dhe cilësia e dyshimtë e mallrave që hyjnë</li> <li>- Mbrojtja e ekonomisë vendore dhe stimulimi i prodhimit vendor</li> <li>- Zhvillimi i tregtimit / eksport - import</li> <li>- Të hyra të tjera nga tatimi ose formë tjetër/qarkullimi i transportit</li> </ul>		<b><u>Përfituesit</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qeveria qendrore (ministritë përkatëse)</li> <li>- Donatorët (organizatat ndërkombëtare)</li> </ul>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes ndihmës së komunitetit ndërkombëtar</li> <li>- Përmes buxhetit komunal</li> <li>- Përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës</li> <li>- Përmes kredive afatgjata</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i projektit detalo - teknik</li> <li>- Përkrahja nga qeveria qendrore (Kosovë)</li> <li>- Përkrahja nga qeveria qendrore (Maqedoni)</li> </ul>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b> - Ekziston projekti detalo - teknik (Zyra Rajonale e Rrugëve në Gjilan dhe në Ministrinë e Transportit - Prishtinë)			
Organizimi i implementimit		Personi kontaktues: Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	150.000	-
	Qeveria qendrore	970.000	-
	Donatorët	960.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL (viti 2006, 2007)		2.080.000	
<b><u>Koha e implementimit</u></b> -Brenda vitit 2005, 2006, 2007		<b><u>Koha e ndikimit</u></b> - Tetori i vitit 2007	

<b>Projekti 21</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Kryerja e projektit për rrugën: Gjilan-Zhegoc-Verbicë e Zhegocit-Sllovi-Lypjan</u></b>		<b><u>Infrastruktura rrugore për komunikim më të mirë</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Në shkurt të vitit 2004, komuna e Gjilanit dhe ajo e Lypjanit janë dakorduar për ndërtimin e rrugës Gjilan-Lypjan, nga drejtimi Zhegoc-Verbicë e Zhegocit-Sllovi-Lypjan, që lidhet me magjistralen Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Durrës. Rëndësia e kësaj rruge qëndron në atë se krijohen kushte të mira edhe për dalje më të shpejtë në Aeroportin e Prishtinës. Në bazë të projektit kryesor, do të bëhet zgjerimi i rrugës, hapja e kanaleve anësore për ujëra, vendosja e gypave dhe përgatitja e saj për fazën e asfaltimit dhe asfaltimi. Ndërsa, sa i përket efekteve ekonomike, komuna e Gjilanit do të ketë interesin e saj në këtë rrugë, sepse, përveç se lidhet me magjistralen dhe Aeroportin e Prishtinës, nga kjo rrugë do të kalojë edhe autoudha Tiranë-Durrës-Prishtinë, pastaj do të krijohen kushte për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, që do të krijonte vende të reja të punës pranë pronave të tyre dhe njëherit do ta ndalte migrimin fshat-qytet.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Do ta ndalnim shpërnguljen e fshatarëve drejt qytetit</li> <li>- Afërsia e Aeroportit dhe magjistrales Prishtinë – Durrës</li> <li>- Efikasiteti i qarkullimit të qytetarëve dhe i mallit</li> <li>- Arritja në kohë më të shpejtë në qendrën spitalore</li> <li>- Intervenimi më i shpejtë në raste urgjente</li> <li>- Lidhjet më të mira dhe më të shkurtëra me fshatrat dhe qytetet tjera</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (komunat Gjilan dhe Lipjan)</li> <li>- Qeveria qendrore (ministrinë përkatëse)</li> <li>- Donatorët (organizatat ndërkombëtare)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes ndihmës së komunitetit ndërkombëtar</li> <li>- Përmes buxhetit komunal</li> <li>- Përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës</li> <li>- Përmes kredive afatgjata</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekziston përkrahja e kuvendeve komunale</li> <li>- Përkrahja nga qeveria qendrore (MTT)</li> <li>- Përkrahja nga qytetarët dhe afaristët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Faza e parë (I): Incizimet gjeodezike të rrugës, shqyrtimet gjeometrike, miha e gjerë e dheut me buldozer, ngjeshja e trupit të rrugës me cilindër, furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit, vendosja e tubave për largimin e ujërave atmosferike apo ndërtimi i urave në vendet e nevojshme deri në bazën e asfaltit. Faza e dytë (II): Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e bito-zhavorit, furnizimi, transporti dhe ngjeshja e asfalt-betonit. (Rruga do të ndërtohet sipas standardeve të ndërtimit, sepse është rrugë rajonale)</p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	90.000	-
	Qeveria qendrore	830.000	-
	Donatorët	730.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL (viti 2006, 2007)		1.650.000	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006, 2007		- Tetori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 22</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Kryerja e projektit për rrugën Zhegër-Goden-Stubëll-Viti</u></b>		<b><u>Infrastruktura rrugore për komunikim më të mirë ndërkufitar dhe ndërkomunal</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Primare për administratën komunale të Gjilanit është që, brenda mundësive maksimale të buxhetit dhe investimeve të tjera (ministritë dhe donatorët), të krijohen kushte më të mira për banorët e Grykës së Karadakut të Gjilanit, duke përfshirë edhe një pjesë të komunës së Vitisë, të rregullohen rrugët dhe të krijohen lidhje të reja me komunat fqinje ndërkomunale dhe ndërkufitare.</p> <p>Faza I /e parë/ e projektit të rrugës Zhegër - Selishtë - Goden, përfshin në vete vetëm zgjerimin dhe mbushjen e rrugës.</p> <p>Në fazën II /e dytë/ në vete përfshin asfaltimin e rrugës Zhegër - Selishtë - Goden - Stubëll - Viti / 8.5 km. Rregullimi i kësaj rruge ka rëndësi të madhe jo vetëm për banorët e kësaj treve, por edhe për komunën e Gjilanit dhe komunën e Vitisë, sepse hap perspektivë për zhvillimin e Grykës së Karadakut dhe rrit kapacitetet e qarkullimit të mallrave dhe njerëzve me komunat fqinje. Komuna e Vitisë në pjesën më të madhe të saj kufizohet me komunën e Gjilanit, ndërsa është vetëm një rrugë, që i lidh këto dy komuna - magjistranja Gjilan - Ferizaj.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Do ta ndalnim shpërnguljen e fshatarëve drejt qytetit</li> <li>- Efikasiteti i qarkullimit të qytetarëve dhe i mallit</li> <li>- Lidhjet më të mira dhe më të shkurtëra me fshatrat dhe qytetet tjera</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale &amp; qytetarët</li> <li>- Ministria e Transportit</li> <li>- Iniciativat e qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (komunat e Gjilanit dhe Vitisë)</li> <li>- Qeveria qendrore (ministritë përkatëse)</li> <li>- Donatorët (organizatat ndërkombëtare)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmes ndihmës së komunitetit ndërkombëtar</li> <li>- Përmes buxhetit komunal</li> <li>- Përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës</li> <li>- Përmes kredive afatgjata</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekziston përkrahja e kuvendeve komunale</li> <li>- Përkrahja nga qeveria qendrore (MTT)</li> <li>- Përkrahja nga qytetarët dhe afaristët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Faza e parë (I): Incizimet gjeodezike të rrugës, shqyrtimet gjeometrike, mihja e gjerë e dheut me buldozer, ngjeshja e trupit të rrugës me cilindër, furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit, vendosja e tubave për largimin e ujërave atmosferike apo ndërtimi i urave në vendet e nevojshme deri në bazën e asfaltit.</p> <p>Faza e dytë (II): Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e bito-zhavorit, furnizimi, transporti dhe ngjeshja e asfalt-betonit.</p> <p>(Rruga do të ndërtohet sipas standardeve të ndërtimit, sepse është rrugë rajonale)</p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	95.000	-
	Qeveria qendrore	335.000	-
	Donatorët	245.000	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL (viti 2006, 2007)		675.000	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006, 2007		- Tetori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 23</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Ndërtimi i ndërtesës së re për Kuvendin Komunal</u></b>		<b><u>Zgjerimi i kapaciteteve fizike dhe institucionale të administratës komunale</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Administrata komunale e Gjilanit funksionon pandërprerë afër gjashtë dekada, me një të kaluar të hidhur dhe shumë të vështirë, të përcjellë edhe me diferencime politike por, megjithatë, ka bërë një organizim të jetës në suaza të një normaleje. Organizimi i ri dhe rrënjësor i administratës komunale me një organizim më demokratik dhe më evropian dhe me krijimin e departamenteve të reja, bëri që të mbulohej të gjitha nevojat apo shërbimet që i mungonin komunës sonë. Problem me të cilin ballafaqohet Kuvendi Komunal i Gjilanit (drejtoritë komunale) është mungesa e një objekti ku do të punonin të gjitha drejtoritë komunale dhe do të jetë një efikasitet në punën dhe në krijimin e kushteve më të mira për qytetarë. Për momentin, drejtoritë komunale janë të shpërndara në tetë (8) objekte me një distancë në mes veti nga 200m-1000m, prandaj po krijohen probleme të mëdha sidomos për qytetarët e komunës sonë, dhe kjo po krijon probleme të shumta në efikasitetin e punës së administratës komunale. Komuna do të sigurojë lokacionin për ndërtimin e objektit, do të krijojë të gjitha lehtësirat e nevojshme, si procedurale ashtu edhe teknike (sigurimin e projektit). Ndërtimi i objektit do të krijojte një efikasitet të madh të administratës komunale, shërbime të shpejta dhe me kohë ndaj qytetarëve, administratë efektive. Objekti do të krijojte kushte dhe hapësirë për të gjitha drejtoritë komunale.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Administratë efektive</li> <li>- Kryerja e shpejtë e shërbimeve ndaj qytetarëve</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qytetarët</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të komunale</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Ministrinë përkatëse (MEF, MPL, MSHP)</li> <li>- Donatorët (organizatat ndërkombëtare)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i lokacionit për ndërtimin e objektit</li> <li>- Fondi për participim në realizimin e projektit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<p>Punët e dheut / hapja e themeleve, punët e betonit, punët e muratimit, punët e armimit, punët e latimit - mbulimit, punët e zdrukthëtarisë, punët e ngjyrosjes dhe fasadimit, punët e qeramikës dhe drynarisë, punët e llamarinës, punët e dyshemesë, punët e kanalizimit dhe të ujësjellësit, punët e elektrikës dhe nxemjes qendrore, punë e tjera...</p>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	150.000	-
	Qeveria qendrore	950.000	-
	Donatorët	464.452	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		1.564.452	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006, 2007		- Tetori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 24</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Trajnimi i stafit komunal për teknologji informative</u></b>		<b><u>Zgjerimi i kapaciteteve fizike dhe institucionale të administratës komunale</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Trajnimi i stafit komunal për teknologji informative ka rëndësi të madhe për stafin e administratës komunale, për arsye se krijohet një efikasitet më i madh në krijimin e një administrate më efektive në shërbim të qytetarëve. Po ashtu, krijohet edhe lidhja tjetër e intranetit, ku do të kenë qasje të gjithë punëtorët e administratës dhe krijohen mundësitë për ruajtjen e shënimeve. Ndryshimet në teknologjinë informative kërkojnë edhe kuadër të kualifikuar menaxherial dhe të profileve të tjera. Projekti ka për qëllim aftësimin e stafit komunal në pajtim me nevojat e administratës komunale. Ky projekt do të realizohet në bashkëpunim me shoqatat lokale dhe ndërkombëtare, të cilat merren me trajnime. Teknologjia informative (trajnimi i stafit) do të siguronte ndërlidhje efikase edhe me qeverinë qendrore (ministrinë përkatëse dhe organizatat ndërkombëtare), të cilat janë të angazhuara në formulimin e politikave, buxhetimit, planifikimit të investimeve. Po ashtu, vlen të ceket se komuna e Gjilanit ka edhe uebfaqen e internetit, ku të gjitha drejtoritë përkatëse komunale kanë pjesën e tyre të aktiviteteve dhe qasjen e drejtpërdrejtë me qytetarë.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritet efikasiteti në punë</li> <li>- Shfrytëzimi maksimal i teknologjisë informative</li> <li>- Ecja me trendet informative</li> <li>- Ndërlidhja më efikase me donatorë dhe institucione të tjera</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qytetarët</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Ministrinë</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Ministrinë dhe donatorët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i stafit dhe dëshira për aftësi informatike</li> <li>- Ekzistimi i rrjetit të internetit dhe uebfaqes komunale</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e mjeteve financiare</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëditjet e ekspertëve dhe ekipit për trajnime</li> <li>- Shpenzimet tjera</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	1.500	-
	Qeveria qendrore	7.300	-
	Donatorët	6.300	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		15.100	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006		- Tetori i vitit 2006	

<b><u>Projekti 25</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Trajnimi i stafit komunal për hartim dhe menaxhim të projekteve</u></b>		<b><u>Zgjerimi i kapaciteteve të administratës komunale</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Komuna e Gjilanit edhe deri tani është dëshmuar si e suksesshme në realizimin e shumë projekteve në të gjithë sektorët e zhvillimit të komunës, mirëpo megjithatë trendet e zhvillimit dhe ecja në hap me to kërkon trajnim të stafit komunal në hartimin dhe menaxhimin e projekteve. Në kushtet bashkëkohore është shumë i rëndësishëm shkëmbimi i përvojave me vendet të cilat e kanë kaluar fazën e tranzicionit, si Sllovenia e Kroacia, sepse kjo ndihmon zhvillimin strategjik të komunës apo, më mirë thënë, qasjen apo orientimin e projekteve detalo-teknike në institucionet të cilat japin grante për zhvillimin e infrastrukturës apo ngritjen e institucioneve komunale. Stafi komunal për trajnime në hartimin dhe menaxhimin e projekteve do të përbëhet nga: ekonomistë, inxhinierë të profileve të ndryshme, arkitektë, gjeodetë etj. Trajnimi i stafit komunal mund të definohet si punë e përbashkët e njerëzve lokalë (zyrtarëve komunalë) me përvojë, për të siguruar ngritje të ekonomisë dhe infrastrukturës, e cila garanton cilësi më të mirë të jetës për qytetarët.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e projekteve detale</li> <li>- Gjetja e donatorëve</li> <li>- Qasja më e mirë e shfrytëzimit të donacioneve</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qytetarët</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qeveria e Kosovës</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> <li>- OJQ-të lokale</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Financues të projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i zyrës për projekte</li> <li>- Ekzistimi i shumë OJQ-ve lokale</li> <li>- Ekzistimi i stafit dhe dëshira për aftësime</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëditjet e ekspertëve dhe ekipit për trajnime</li> <li>- Shpenzimet tjera</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	4.500	
	Qeveria qendrore	7.300	
	Donatorët	6.300	
	Iniciativa të tjera	-	
TOTAL		18.100	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006		- Tetori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 26</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Trajnimi i inkasantëve tatimorë komunale</u></b>		<b><u>Zgjerimi i kapaciteteve të administratës komunale</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Organizimi i ri dhe rrënjësor i administratave komunale me një hierarki më demokratike dhe më evropiane dhe krijimi i departamenteve të reja, bëri që të mbulohej të gjitha nevojat apo shërbimet që i mungonin komunës sonë. Mirëpo, shkëmbimi i përvojave apo i eksperiencave me vendet që më herët kanë filluar fazën e tranzicionit do të jetë i domosdoshëm, sepse me këmbimin e përvojave do t'i ngrisin dhe forcojmë organet tona komunale, njëherit do t'i mbulojmë ato zbrazëtira që për momentin ekzistojnë. Të hyrat vetanake brenda komunës janë: të hyrat nga biznesi - taksat komunale, të hyrat nga urbanizimi (pëlqimet, lejet e ndërtimit), të hyrat nga lejet e punës, të hyrat nga dënimet në komunikacion etj., ndërsa që nga viti 2002 së pari si pilot-projekt është filluar edhe me një lloj të të hyrave komunale - të hyrat nga tatimi në pronë, që i ka mundësuar komunës sonë rritjen e të hyrave vetanake. Po ashtu, Kuvendi Komunal, në mbledhjen e vet të rregullt, ka aprovuar rregulloren për implementimin e tatimit në pronë, mirëpo, megjithatë, edhe pse janë regjistruar të gjitha patundshmëritë, niveli i pagesës nuk është i kënaqshëm. Andaj, trajnimi i inkasantëve tatimorë komunale dhe organizimi i një kampanje për vetëdijësimin e qytetarëve do ta ngriste nivelin e pagesës, e me këtë do të rriten të hyrat në buxhetin komunal dhe do të krijohet një urë lidhëse qytetar-komunë, e cila do të rezultonte me realizimin e shumë projekteve në shërbim të qytetarëve. Me vendimin e aprovuar të Kuvendit Komunal të Gjilanit gjatë këtij viti (2005) do të ketë zbritje normative tatimore për 25%, tek të gjitha kategoritë e objekteve, por nuk do të ketë falje të borxheve të mëhershme, por vetëm shtyrje të tyre. Të gjitha mjetet e grumbulluara nga tatimi në pronë do të shfrytëzohen ekskluzivisht për përmbushjen e nevojave në rregullimin e infrastrukturës, e cila do të jetë në shërbim të qytetarëve.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e të hyrave në buxhetin komunal</li> <li>- Ngritja e kapaciteteve të shërbimit të inkasimit</li> <li>- Krijimi i një infrastrukture më të mirë</li> <li>- Bashkëpunimi më i mirë me qytetarë</li> <li>- Njohja me rregulloret e reja</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale (shërbimi i inkasimit)</li> <li>- Drejtoria për Buxhet dhe Financa</li> <li>- Qytetarët</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- MEF</li> <li>- Donatorët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i rregullores komunale mbi tatimin në pronë</li> <li>- Ekzistimi i shërbimit të sektorit mbi pronë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpenzimet e organizimit të trajnimit</li> <li>- Shpenzimet e organizimit të një kampanje (katalogët, mediat lokale)</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	1.300	-
	Qeveria qendrore	4.600	-
	Donatorët	4.600	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		10.500	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Shtatori i vitit 2006	

<b><u>Projekti 27</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Rregullorja për thjeshtësimin e procedurave administrative biznesore</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko-administrative e bizneseve</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Nxjerrja e rregullores komunale për thjeshtësimin e procedurave administrative biznesore është identifikuar si nevojë e cila do të lehtësonte procedurat administrative (rreth marrjes së lejes së punës, pranimit teknik të objekteve afariste, si dhe mundësia e lirisht nga taksat komunale për bizneset fillestare për periudhën e parë gjashtëmujore). Po ashtu, do të kërkohet nga qeveria qendrore (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) që regjistrimi dhe çregjistrimi i subjekteve afariste të bëhet në nivel të komunës, ku qytetari (afaristi) do t'i ketë më afër institucionet qendrore, po ashtu do të krijonte lehtësira, shpenzime më të vogla dhe moshumbje kohe për të regjistruar një biznes. Kjo rregullore e thjeshtësimit të procedurave administrative biznesore do të jetë nxitje për t'u marrë me aktivitet biznesor, gjegjësisht do të rritet numri i NVM-ve në komunën tonë. Nxjerrja e rregullores do të bëhet në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi dhe Menaxhment, sektorin ligjor brenda komunës, pastaj do të marrin pjesë edhe afaristë, OJQ-të lokale, qytetarë dhe organizata ndërkombëtare etj. Mirëpo, vlen të theksohet se kjo rregullore do të nxirret në përputhje me Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla, sipas së cilës "ndërmarrjet e vogla janë shtylla kurrizore e ekonomisë, janë burim kryesor i vendeve të reja të punës".</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lehtësira për afaristët lokalë</li> <li>- Mjedis më i mirë për biznes</li> <li>- Ekonomi lokale më dinamike</li> <li>- Vende të reja të punës</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat afariste</li> <li>- MTI, MEF, MPL</li> <li>- Qytetarët</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat afariste</li> <li>- MTI, MEF, MPL dhe</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues të projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i kushteve për nxjerrjen e rregullores</li> <li>- Ekzistimi i shumë OJQ-ve lokale (afariste)</li> <li>- Nevoja e domosdoshme për rritjen e ekonomisë lokale</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i afaristëve dhe i OJQ-ve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëditjet e ekspertëve dhe ekipit për nxjerrjen e rregullores (takimet e shumta, aprovimi në kuvend)</li> <li>- Publikimi i rregullores në mediat lokale</li> <li>- Shtypja e katalogëve për rëndësinë e rregullores për zhvillimin e NVM-ve</li> <li>- Reklama dhe propaganda në mediat lokale</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	1.700	
	Qeveria qendrore	3.100	
	Donatorët	3.100	
	Iniciativa të tjera	-	
TOTAL (Viti 2005)		7.900	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Gjashtëmujori i vitit 2006	

<b><u>Projekti 28</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Zyra e shërbimeve të shpejta për biznese</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko-administrative e bizneseve</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Një grup ekspertësh nga administrata lokale, duke pasur parasysh se shumë ndërmarrës nuk posedojnë informacione mbi procedurat e ndryshme administrative lokale, si dhe me qëllim të eliminimit të mosmarrëveshjeve rreth procedurave dhe thjeshtësimit të tyre në nivelin e minimumit të domosdoshëm, kanë vendosur ta hapin një zyrë për shërbime të shpejta për komunitetin e biznesit. Zyra për shërbime të shpejta do të ofrojë informata relevante mbi të gjitha procedurat për marrjen e lejeve të punës, procedurat dhe shpenzimet. Zyra mund të veprojë edhe si ndërmjetësuese gjatë procedurave të regjistrimit, nxjerrjes së lejeve etj. Gjithashtu, do të njoftojë komunitetin e biznesit lidhur me ndryshimet në legjislacion ose në procedurat administrative. Kësisoj, zyra do të rrisë partneritetin me komunitetin e biznesit dhe do të jetë një bazë e të dhënave lidhur me bizneset që veprojnë në territorin e komunës, të nevojshme për investitorët potencialë. Në vitin e parë shërbimet që ofron kjo zyrë do të jenë falas, ndërsa në vitet vijuese do ta kenë një çmim të arsyeshëm. Kjo zyrë do të jetë në kuadër të komunës, e cila do t'i koordinojë punët me të gjitha drejtoritë që janë të targetuara me shërbimet e sektorit privat. Do të informojë sektorin privat për të gjitha obligimet ndaj komunës, si dhe do të ofrojë kryerjen e këtyre shërbimeve në një afat më të shkurtër.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkrahja e zhvillimit të biznesit lokal</li> <li>- Përkrahja e ndërmarrësve të rinj</li> <li>- Rrit besimin e bizneseve në QL</li> <li>- Zvogëlon dështimet në biznes</li> <li>- Rrit të hyrat nga taksat për QL</li> <li>- Përmirëson rrethinën afariste</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Ministria e Industrisë dhe Tregtisë</li> <li>- Ndërmarrësit ekzistues</li> <li>- Ndërmarrësit e rinj potencial</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shoqata e afaristëve dhe ekonomistëve</li> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekziston udhëheqësi i projektit</li> <li>- Objekti në dispozicion</li> <li>- Zotimi i qeverisë lokale</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pagat e ekipit për implementimin e projektit</li> <li>- Renovimi i zyrës</li> <li>- Pajisjet e zyrës (inventarizimi dhe lidhja në rrjetin e internetit)</li> <li>- Trajnimi i stafit dhe marketigu</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	3.500	-
	Qeveria qendrore	14.200	-
	Donatorët	14.200	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		31.900	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
Brenda vitit 2005		- Gjashtëmujori i vitit 2006	

<b><u>Projekti 29</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Publikimi i buletinit për rregullore dhe legjislacion komunal dhe trende ekonomike</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko-administrative e bizneseve</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Ekipi për ZHEL e ka paraparë si të domosdoshme nxjerrjen e një buletini ku do të publikoheshin rregulloret komunale, ndryshimet në rregullore dhe trendet ekonomike (duke përfshirë ligjet e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës, pastaj vendimet e nxjerra nga AKM mbi privatizimin e pronës shoqërore brenda komunës së Gjilanit), të cilat do të informonin biznesin privat me rregulloret në fuqi. Para fillimit të nxjerrjes së buletinit duhet të bëhet definimi dhe aprovimi i Rregullores për botim të buletinit, sepse buletini duhet të nxirret në dy gjuhë, me qëllim të përfshirjes (informimit) të të gjithë qytetarëve të komunës. Buletini do të nxirret në çdo tremujor (brenda vitit 4 numra), ku do të përfshihen të gjitha rregulloret, legjislacioni komunal dhe trendet ekonomike.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njoftimi i qytetarëve me rregulloren në fuqi</li> <li>- Vetëdijësimi i qytetarëve për zbatimin e tyre</li> <li>- Propozimet nga qytetarët dhe OJQ-të lokale për ndryshimet dhe plotësime, nëse ka nevojë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qytetarët</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Asambleja Komunale</li> <li>- Qeveria e Kosovës (ministritë përkatëse)</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qeveria qendrore (MSHP, MPL, MEF, MTI)</li> <li>- Donatorët</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i rregulloreve të aprovuara</li> <li>- Ekzistimi i nevojave për publikim</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i qytetarëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Caktimi i zyrtarit përgjegjës për përgatitjen e Informatorit (Buletinit)</li> <li>- Sigurimi i shpenzimeve materiale të zyrës</li> <li>- Përgatitja, përkthimi, lektorimi dhe botimi i buletinit në gjuhën shqipe dhe serbe</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismaili, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	3.400	
	Qeveria qendrore	3.600	
	Donatorët	3.800	
	Iniciativa të tjera	-	
TOTAL (viti 2005, 2006)		10.800	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005, 2006, 2007		- Tetori i vitit 2007	

<b>Projekti 30</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Themelimi i një trupe komunale për koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe diasporës</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko-administrative e bizneseve</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Angazhimi dhe strategjia e komunës së Gjilanit në periudhën e deritashme ka qenë e drejtuar në ndërtimin e institucioneve dhe në ngritjen e kapaciteteve të tyre, sipas standardeve europiane, si dhe në planifikimin e kujdesshëm afatgjatë dhe vizionin e qartë për zhvillimin e komunës. Ne dëshirojmë të ndërtojmë shërbim komunal që garanton efikasitet dhe cilësi të punës, kushte më të mira në arsim, mbrojtje më të mirë shëndetësore për të gjithë banorët e komunës, përparim ekonomik, shtim të vendeve të punës, për arsye se ne do të bëjmë çdo gjë që është e mundur që të sigurohemi që varësia jonë nga donatorët të jetë sa më e vogël. Andaj, themelimi i një trupe komunale për koordinim të aktiviteteve diasporë - komunë është i domosdoshëm për mbështetjen e programeve investive. Sfida kryesore me të cilën sot ballafaqohet komuna e Gjilanit është shkalla e lartë e papunësisë, deindustrializimi, infrastruktura e dobët, problemet me hapësirën shkollore, sistemi i pareformuar ekonomik, prandaj sot është i rëndësishëm inkurajimi i investimeve kapitale të mërgatës shqiptare dhe investitorëve të huaj, për arsye se do të ngrisim zhvillimin e ekonomisë familjare, zejtarisë, veprimtarive shërbyese, rivitalizimin e fondit blegtoral dhe mekanizmit të infrastrukturës bujqësore, ndërtimin e kopshteve, serave dhe ngritjen e fermave, kështu që do të zvogëlojmë shkallën e papunësisë në vend. Komuna ka edhe uebfaqen e internetit, ku diaspora do të ketë mundësi të informohet dhe të kontaktojë për të gjitha veprimtaritë e zhvilluara në komunë, si dhe lehtësirat që do t'i ofrojë komuna për diasporën.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Koordinimi i aktiviteteve</li> <li>- Bashkëpunimi më i mirë komunë-diasporë</li> <li>- Rritja e mundësive investuese nga diaspora</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qytetarët</li> <li>- Ministrinë përkatëse</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Ministrinë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i numrit të madh të qytetarëve në diasporë</li> <li>- Ekzistimi i potencialit financiar nga diaspora</li> <li>- Ekzistimi i përkrahjes nga komuna</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i diasporës</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimi i takimeve me diasporën (korrik dhe dhjetor)</li> <li>- Shpenzimet e komunikimit përmes internetit dhe telefonit</li> <li>- Publikimi i katalogjeve për kushtet - lehtësirat e ofruara nga komuna</li> <li>- Reklama dhe propaganda në mediat lokale dhe qendrore</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	1.600	-
	Qeveria qendrore	2.300	-
	Donatorët	2.400	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		6.300	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2005		- Tetori i vitit 2006	

<b>Projekti 31</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Ndërtimi i zonës industriale në Shillovë</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko - financiare e bizneseve</u></b>	
<b>Përshkrimi i shkurtër i projektit</b>			
<p>Zona industriale do të mundësojë një impuls të ri për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, që do t'u mundësojë bizneseve sipërfaqe të urbanizuara me infrastrukturë moderne për zhvillimin e aktiviteteve, në radhë të parë atyre prodhuese. Bizneset potenciale, që janë duke kërkuar mundësitë e një biznesi të zhvilluar modern në botën e globalizuar, e cila është në rritje e sipër, për të hapur dyer të vizioneve të reja bashkëpunimeve dhe lidhjeve ndërkombëtare dhe dhënies së shërbimeve të tjera, do të kenë mundësi të arrijnë të gjitha këto më lehtë në zonën industriale. Zona industriale në Shillovë shtrihet në aksin rrugor Gjilan-Bujanovc, ku pas përfundimit të luftës një numër i madh i NMV-ve i kanë shtrirë aktivitetet e tyre biznese, andaj është obligim i komunës që ta rregullojë infrastrukturën dhe ta legalizojë atë.</p>			
<b>Rezultatet e pritshme</b>		<b>Përfituesit</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i bazës së qëndrueshme për realizimin e objektivave tona zhvillimore</li> <li>- Përmirësimi i rrethinës afariste</li> <li>- Nxit zhvillimin e biznesit privat</li> <li>- Krijon mundësi për rritjen e interesimit për investime në sektorin privat nga donatorët (për shkak të pozitës ideale për këtë lloj biznesi)</li> <li>- Përqendron prodhuesit industrialë në një zonë me infrastrukturë të rregulluar (të përbashkët)</li> <li>- Favorizon krijimin e ndërmarrjeve të reja industriale (duke marrë parasysh se Gjilani ka traditë dhe resurse të mjaftueshme)</li> <li>- Krijon mundësi për thithjen e kapitalit nga diaspora (për shkak të parakushteve mjaft të mira)</li> <li>- Krijimi i vendeve të reja të punës</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komuniteti i biznesit</li> <li>- Administrata lokale</li> <li>- Të papunët</li> <li>- Komunitetet</li> <li>- Diaspora</li> <li>- Investitorët e jashtëm dhe të brendshëm</li> </ul>	
<b>Akterët e mundshëm</b>		<b>Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komuniteti i biznesit</li> <li>- Administrata lokale</li> <li>- Të papunët</li> <li>- Komunitetet</li> <li>- Diaspora</li> <li>- Investitorët e jashtëm dhe të brendshëm</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqësi i projektit</li> <li>- Asistencë teknike dhe financiare</li> <li>- Investime në sektorin privat</li> <li>- Mbështetës i mundshëm i projektit</li> </ul>	
<b>Parakushtet</b>		<b>Faktorët e rrezikut</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lokacioni i propozuar është pronë komunale - private</li> <li>- Sipërfaqe e mjaftueshme e hapësirës afariste</li> <li>- Ka qasje në rrugët qarkore që janë në gjendje mesatarisht të mirë</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i NMV-ve</li> </ul>	
<b>Shpenzimet e llogaritura</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullimi i infrastrukturës (rrugë, ujësjellës, kanalizim, rrymë, rrjet telekomunikues etj.)</li> <li>- Ekspropriimi i pronës me interes të përgjithshëm</li> </ul>			
<b>Organizimi i implementimit</b>		<b>Personi kontaktues:</b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</b>	<b>Burimet e financimit</b>	<b>Shuma e planifikuar</b>	<b>Shuma e siguruar</b>
	Qeveria lokale	150.000	-
	Qeveria qendrore	470.000	-
	Donatorët	470.000	-
	Iniciativa të tjera	65.000	-
	TOTAL	1.155.000	-
<b>Koha e implementimit</b>		<b>Koha e ndikimit</b>	
Brenda vitit 2006, 2007		Nëntori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 32</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Krijimi i inkubatorit të biznesit</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko-financiare e bizneseve</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Ekonomia e komunës së Gjilanit në periudhën e viteve 1990-1999 pësoi dëme dhe shkatërrime të mëdha dhe edhe sot, pas më shumë se pesë vjetësh, nuk ka arritur të rehabilitojë potencialin e saj ekonomik. Problemet me të cilat ballafaqohet ekonomia shoqërore e komunës sonë janë: mungesa e mjeteve xhiruese, sigurimi i lëndës së parë, burimet për mjete investive dhe humbja e tregjeve. E gjithë kjo e shton domosdoshmërinë që në strategjinë e zhvillimit afatmesëm të komunës, aktivitetin e vet mbi të gjitha ta orientojë në zhvillimin e NVM-ve e, në kontekst të kësaj, edhe në krijimin e një inkubatori të biznesit në territorin e komunës. Inkubatori mund të jetë mjet i promovimit të llojeve specifike të aktiviteteve ekonomike apo të inkurajojë grupe të ndryshme specifike (bizneset familjare) të paavancuara. Hapësira punuese e menaxhuar, për më tepër, ofron qasje në shërbimet e përbashkëta (në informata, sekretari, administratë, marketing, financa etj.). Segment mjaft i rëndësishëm të inkubatori i biznesit është edhe përballimi i shpenzimeve të punës, e sidomos të qirasë, e cila edhe në komunën tonë për biznesin e vogël është e pavolitshme. Qiraja që nga fillimi do të niste nga niveli prej 20% të qirasë komerciale dhe do të ngritjej për 20% në çdo gjashtëmujorësh, deri në maksimumin 120% të qirasë komerciale. Po ashtu, zvogëlimi i qirasë do t'u ofronte lehtësime punëdhënësve të cilët krijojnë vende të reja të punësi: me punësimin e 2-3 punëtorëve, qiraja u zvogëlohet 10%; me punësimin e 4-5 punëtorëve, qiraja u zvogëlohet për 15%; me punësimin e 6-8 punëtorëve qiraja u zvogëlohet 20% dhe me punësimin e mbi 8 punëtorëve qiraja u zvogëlohet 25%.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shtimi i numrit të të punësuarve</li> <li>- Promovimi i fushave të veçanta të veprimit</li> <li>- Avancimi i bizneseve familjare</li> <li>- Përmirësimi i ambientit të biznesit (hapësirës)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat e biznesit</li> <li>- Ministrinë përkatëse</li> <li>- Zyra Rajonale e Punësimin</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat e biznesit</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> <li>- MTI, MEF, MPL, MPMS</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> <li>- Bashkëfinancues të projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gatishmëria e buxhetit të komunës për participim në projekt</li> <li>- Kuadri i nevojshëm për menaxhim</li> <li>- Interesimi i bizneseve familjare për hyrje në inkubator</li> <li>- Ekzistimi i objektit</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i NMV-ve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hulumtimi i nevojave për zhvillimin e NMV-ve</li> <li>- Rehabilitimi i objektit për nevoja të inkubatorit</li> <li>- Krijimi i hapësirave të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive afariste</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	-
	Qeveria lokale	120.000	-
	Qeveria qendrore	325.000	-
	Donatorët	355.000	-
	Iniciativa të tjera	60.000	-
TOTAL		860.000	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006		- Dhjetori i vitit 2007	

<b>Projekti 33</b>		<b>Lloji i programit</b>	
<b><u>Krijimi i fondit për rivitalizim të bujqësisë/bletarisë</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko-financiare e bizneseve</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Pozita e mirë gjeografike, kullosat (livadhet), kushtet e mira dhe uji i bollshëm janë vetëm disa elemente që jo vetëm e karakterizojnë komunën tonë, por edhe i detyrojnë bujqit të kenë një qasje më serioze për marrjen me blegtori, pemëtari, bletari, ndërtimin e serave për kultivimin e perimeve të hershme etj. Gruri, misri, perimet janë prodhimet kryesore, duhani ishte gjithashtu njëri prej prodhimeve kryesore bujqësore, por prodhimi i tij po bie në mënyrë konstante gjatë dekadës së fundit.</p> <p>Në planin e zhvillimit strategjik synimet zhvillimore në bujqësi orientohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rivitalizimin e fondit blegtoral, mekanizimit dhe infrastrukturës bujqësore</li> <li>- ndërtimin e kopshteve të prodhimit, perimeve</li> <li>- ngritjen e një ferme për prodhimin e qumështit</li> <li>- investimet në stacionin e veterinarisë</li> <li>- ngritjen e kooperativave dhe barnatoreve bujqësore</li> <li>- mbrojtjen nga insektet /pyjeve, fushave, perimeve, pemëve etj.</li> </ul> <p><b><u>Nga këto arrihen këto efekte:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) kalimi nga mënyra e vjetër e prodhimit individual në prodhimtari të gjerë për treg</li> <li>b) shfrytëzimi maksimal si i potencialit njerëzor ashtu edhe i atij ekonomik</li> <li>c) krijimi i vendeve të reja të punës pranë pronave të tyre</li> <li>d) ndalimi i migrimit të popullsisë fshat - qytet dhe, më e rëndësishmja,</li> <li>e) plotësimi i nevojave të qytetarëve tanë me ushqim të shëndoshë dhe cilësor.</li> </ol> <p>Krijimi i fondit për rivitalizim të bujqësisë do të krijonte një bazë të mirë për zhvillimin e këtij sektori, i cili do të krijonte mundësi për zgjerimin e kapaciteteve të prodhimeve bujqësore.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Stimulimi i bujqve</li> <li>- Rritja e rendimeteve</li> <li>- Rritja e konkurrencës në treg</li> <li>- Fitimi i njohurive të reja</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Ministria e Bujqësisë</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Ministria e Bujqësisë</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gatishmëria e kuadrit profesional</li> <li>- Motivimi i ndërmarrësve për hapjen e bizneseve të reja</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e fondeve të mjaftueshme</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndarja e një pjese të buxhetit komunal për formimin ( krijimin ) e fondit për revitalizim</li> <li>- Bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës dhe paraqitja e kërkesës për participim në fondit për revitalizim</li> <li>- Bashkëpunimi me Donator dhe paraqitja e kërkesës për participim në fondit për revitalizim</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	120.000	-
	Qeveria qendrore	325.000	-
	Donatorët	355.000	-
	Iniciativa të tjera	60.000	-
TOTAL		860.000	
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006		- Gjashtëmujori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 34</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Formimi i skemës kredituese bujqësore</u></b>		<b><u>Mbështetja tekniko - financiare e bizneseve</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Skema kredituese bujqësore duhet të funksionojë brenda Drejtorisë për Bujqësi dhe qëllim parësor i kësaj skeme është hapja e vendeve të reja të punës, pastaj mbështetja e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla bujqësore. Po ashtu, roli i kësaj skeme është se jep garancion për kredi me kushte të volitshme, njëherit bën promovimin e prodhimeve dhe jep ndihmë profesionale. Skema kredituese do t'i ketë rregullat shumë të qarta dhe strikte, p.sh. për të fituar të drejtën për aplikim në kredi duhet të jesh banor i komunës, sikur edhe veprimtaria e cila zhvillohet duhet të jetë brenda komunës. Kapitali i skemës kredituese do të jetë një pjesë nga buxheti i komunës, pastaj Ministria për Ekonomi, Ministria e Bujqësisë, bankat afariste dhe iniciativat e tjera afariste. Përfitimet e bujqve nga kjo skemë do të jenë: më lehtë vijnë deri te marrja e kredisë, shpenzimet janë shumë më të vogla, si dhe marrja e ndihmës profesionale. Anëtarë të skemës kredituese do të jenë të gjithë afaristët e komunës sonë, të cilët do të paguajnë për anëtarësimin në skemë, ndërsa skema do të udhëhiqet nga këshilli garantues.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Stimulimi i bujqve</li> <li>- Rritja e rendimenteve</li> <li>- Rritja e konkurrencës në treg</li> <li>- Fitimi i njohurive të reja</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Ministria e Bujqësisë</li> <li>- Ministria e Ekonomisë</li> <li>- Bankat afariste</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Shoqatat dhe OJQ-të lokale</li> <li>- Ministria e Bujqësisë</li> <li>- Ministria e Ekonomisë</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gatishmëria e komunës për participim në skemën kredituese</li> <li>- Motivimi i ndërmarrësve për hapjen e bizneseve të reja</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e fondeve të mjaftueshme</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndarja e e një pjese të buxhetit komunal për participim në skemën kredituese</li> <li>- Bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës dhe paraqitja e kërkesë për participim në formimin e skemës kredituese</li> <li>- Bashkëpunimi me Donator, Banka afariste dhe mikrofinanciare dhe paraqitja e kërkesë për participim në formimin e skemës kredituese</li> <li>- Bashkëpunimi me ndërmarrës bujqësor dhe paraqitja e projektit dhe kërkesës për participim në formimin e skemës kredituese</li> <li>- Formimi i këshillit garantues nga akteret që do të participojn në formimin e skemës</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	30.000	-
	Qeveria qendrore	63.000	-
	Donatorët	67.000	-
	Iniciativa të tjera	5.600	-
TOTAL		165.600	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006		- Gjashtëmujori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 35</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Trajnimi i personave të pakualifikuar në profile të ndryshme</u></b>		<b><u>Aftësimi praktik i personave të pakualifikuar</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Brenda MPMS ekziston Departamenti i Punës dhe Punësimit, në kuadër të të cilit vepron rrjeti në disa qendra të Kosovës. Kështu, në komunën e Gjilanit ekziston Qendra Rajonale e Punësimit, e cila në kuadër të vetin ka edhe Qendrën e Aftësimeve Profesionale, e cila, në sajë të bashkëpunimit të mirë me administratën komunale dhe në sajë të menaxhimit të mirë, ka arritur të identifikojë të gjitha nevojat për trajnime në bazë të kërkesës së tregut. Gjatë përgatitjes së strategjisë, bashkërisht me Qendrën Rajonale të Punësimit, është paraparë si nevojë imediate nevoja për këto lloje trajnimesh: trajnimi për marketing dhe plane të biznesit, trajnimi për standarde të reja të kontabilitetit, trajnimi i profileve të ndryshme të inxhinierisë, trajnimi bujqësor, trajnimi për zanatçi, trajnimi për kompjuter dhe internet etj. Trajnimi i personave të pakualifikuar në profile të ndryshme do të ndikonte në masë të madhe në përmirësimin e mundësive të punësimit të të papunëve të regjistruar, nëpërmjet freskimit të diturisë dhe kualifikimeve të nevojshme për tregun e punës.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zvogëlimi i papunësisë</li> <li>- Krijimi i profileve në bazë të nevojave të tregut</li> <li>- Ngritja e mirëqenies ekonomike</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qendra Rajonale e Punësimit</li> <li>- Qeveria lokale / DEM</li> <li>- Shoqatat afariste dhe të zanatçive</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		<b><u>Kontributet e mundshme në projekt</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qendra Rajonale e Punësimit</li> <li>- Qeveria lokale / Departamenti për Ekonomi dhe Menaxhment (DEM)</li> <li>- Qeveria qendrore / MTI, MPMS, MPL</li> <li>- Shoqatat afariste dhe të zanatlive</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i QRP (Qendra Regionale për Punësim) / Qendra e Aftësimeve Profesionale</li> <li>- Ekzistimi i numri të madh të të papunëve pa kualifikim</li> <li>- Gatishmëria e komunës dhe QRP për bashkëpunim</li> <li>- Ekzistimi i objektit të përshtatshëm për trajnime</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i donatorëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëditjet e trajnuesve</li> <li>- Shpenzimet tjera të organizimit të trajnimeve</li> <li>- Shpenzimet për mjete teknike të nevojshme për trajnim</li> </ul>			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	3.200	-
	Qeveria qendrore	11.300	-
	Donatorët	11.300	-
	Iniciativa të tjera	-	-
TOTAL		25.800	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006 /2007		- Tetori i vitit 2007	

<b><u>Projekti 36</u></b>		<b><u>Lloji i programit</u></b>	
<b><u>Aftësimi praktik i maturantëve të diplomuar</u></b>		<b><u>Aftësimi praktik i maturantëve të diplomuar</u></b>	
<b><u>Përshkrimi i shkurtër i projektit</u></b>			
<p>Në shkollat e mesme të komunës së Gjilanit mësimet i vijojnë 5.326 nxënës, të orientuar në këto profile: Drejtimi Ekonomik dhe Juridik, Teknik dhe Elektroteknik, Gjinnazi, Drejtimi i Mjekësisë dhe Drejtimi i Bujqësisë. Një numër i nxënësve, pas përfundimit të shkollës së mesme, orientohen në universitete të ndryshme, duke përfshirë edhe universitetet private në Prishtinë, Tetovë, Tiranë dhe në universitete të tjera, mirëpo një numër i madh i nxënësve, për shkak të kushteve financiare dhe për shkak të suksesit jo të duhur, janë të detyruar të mos i vijonë mësimet. Gjatë përgatitjes së strategjisë, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit, është paraparë si nevojë aftësimi praktik i maturantëve të diplomuar të profileve të ndryshme.</p> <p>Vlen të ceket se në disa profesione ekzistojnë aftësime praktike, si drejtimi i Teknikës, ku ekziston objekti për aftësimin praktik të nxënësve për automekanik. Po ashtu, edhe në drejtimin e Mjekësisë ekziston aftësimi praktik i maturantëve në spitalin rajonal, mirëpo shtrohen si nevojë dhe domosdoshmëri aftësimet praktike edhe për drejtimin Ekonomik dhe Juridik, pastaj të Bujqësisë, Gjinnazin dhe disa drejtimeve të tjera. Gjilani ka kapacitete si të sektorit privat (bizneset private, bankat) dhe të atij publik (Posta, KEK-u, Hidromorava, Higjiena, Gjykata), por edhe brenda administratës komunale, që ta bëjë aftësimin praktik të maturantëve të diplomuar ose para diplomimit. Drejtorja Komunale e Arsimit, bashkërisht me Drejtorinë Komunale për Ekonomi dhe Menaxhment, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Odën Ekonomike Rajonale, Qendrën për Aftësime Profesionale, pastaj shoqatat e ndryshme të zhvillimit të bujqësisë dhe shoqatat afariste, do të punojë në ngritjen e kapaciteteve për aftësimin praktik të maturantëve të diplomuar.</p>			
<b><u>Rezultatet e pritshme</u></b>		<b><u>Përfituesit</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësimi i maturantëve për punë praktike</li> <li>- Zvogëlimi i papunësisë</li> <li>- Krijimi i profileve në bazë të nevojave të tregut</li> <li>- Ngritja e mirëqenies ekonomike</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qendra Rajonale e Punësimit</li> <li>- Qeveria lokale / DA, DEM, DSHP</li> <li>- Shoqatat afariste dhe të bujqësisë</li> <li>- Ndërmarrjet afariste</li> </ul>	
<b><u>Akterët e mundshëm</u></b>		Kontributet e mundshme në projekt	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qendra Rajonale e Punësimit</li> <li>- Qeveria lokale</li> <li>- Qeveria qendrore / MTI, MPMS, MPL</li> <li>- Shoqatat afariste dhe të bujqësisë</li> <li>- Organizatat ndërkombëtare</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqës i projektit</li> <li>- Asistencë teknike</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> <li>- Bashkëfinancues i projektit</li> </ul>	
<b><u>Parakushtet</u></b>		<b><u>Faktorët e rrezikut</u></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzistimi i QRP / Qendra e Aftësimeve Profesionale</li> <li>- Ekzistimi i numrit të madh të maturantëve</li> <li>- Gatishmëria e komunës për bashkëpunim</li> <li>- Ekzistimi i objektit të përshtatshëm për trajnime</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e buxhetit</li> <li>- Mosinteresimi i maturantëve</li> </ul>	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura</u></b>			
- Shpenzimet e organizimit të trajnimeve			
<b><u>Organizimi i implementimit</u></b>		<b><u>Personi kontaktues:</u></b> Ekipi për ZHEL - Fadil Osmani, Bahrije Mahmuti, Hamdi Ismajli, Sevdije Hyseni - tel.0280/20-783	
<b><u>Shpenzimet e llogaritura (burimet e mjeteve)</u></b>	<b><u>Burimet e financimit</u></b>	<b><u>Shuma e planifikuar</u></b>	<b><u>Shuma e siguruar</u></b>
	Qeveria lokale	1.200	-
	Qeveria qendrore	2.300	-
	Donatorët	2.300	-
	Iniciativa të tjera	-	-
	TOTAL	5.800	-
<b><u>Koha e implementimit</u></b>		<b><u>Koha e ndikimit</u></b>	
- Brenda vitit 2006 /2007		- Tetori i vitit 2007	

## **ANEKS. PALËT E INTERESUARA**

### **Zyret Regjionale të Ministrive të Qeverisë Qendrore:**

Zyrja Regjionale e Ministrisë së Tregisë dhe Industrisë - Shaban Ismajli  
Zyrja Regjionale e Ministrisë së Arsimit - Remzi Ahmeti  
Zyrja Regjionale e Punësimit - Xhevat Aliu  
Zyrja Regjionale e Çështjeve Sociale - Enver Halili  
Zyrja Regjionale e Administratës Tatimore - Fahri Raqi  
Zyrja Regjionale e Rrugëve - Ismet Halili  
Zyrja Regjionale e Statistikës - Isa Bunjaku

### **Bizneset Individuale:**

“Bejta Komerc” - Bejtullah Kqiku  
“Agrohermes” - Abdyl Aliu  
“Banka për Biznes” - Bajram Fejzullahu  
“Eximor” – Ridvan Ismaili  
“Ri – Ad” – Adnan Rahimi  
“Vision” – Qemajl Mustafa

### **Qendrat / Asociacionet Biznesore:**

Agjencia Regjionale e Ndërmarrjeve - Gani Pireva  
Zyrja Regjionale e Odës Ekonomike - Ibrahim Tahiri

### **Partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin Komunal:**

LDK - Abdyl Kadriu  
PDK – Ismajl Kurteshi  
AAK - Fadil Gashi  
ORA - Nazim Jashari

**Institucionet tjera:**

Përfaqësuesi i UNMIKut - Vladimir Anokin

KFOR - LTL Richard Jonson

Klubi i Gazetarëve "Beqir Musliu" - Musa Sabedini

Instituti Lindje-Perëndim - Valbona Tahiri

KMDLNJ - Fazli Abdullhau

OJQ "Ataturku" - Kemal Shahin

OJQ ndërkombtare "Catholic Relief Services" - Fatushe Haliti



---

### **Ekipi Menaxhues i Projektit DELTA II**

Scott Abrams  
Menaxher i Programit DELTA  
Instituti për Shoqëri të Hapur

Sejdi Osmani – Koordinator  
Mr. Salvador Elmazi – Menaxher  
Albana Gashi – Trajner / Fasilitator  
Besa Gashi - Trajner / Fasilitator

---

### **Konsultantët e Projektit DELTA II**

Prof. Dr. Muhamet Mustafa - Kryetar i Institutit Riinvest  
Prof. Dr. Isa Mustafa – Nënkyetar i Institutit Riinvest  
Gwen Swinburn – specialiste për çështje urbane nga Banka Botërore  
Carmen Zarzu – specialiste e pavarur për ZhEL nga Rumania  
Prof. Dr. Miroslav Glas – Fakulteti Ekonomik i Lubjanës  
James Budds – specialist i pavarur për ZhEL nga ShBA-të  
Fergus Murphy - specialist i pavarur për ZhEL nga ShBA-të  
Safet Zejnullahu – Lektor në Shqip

---